FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 73

Tiranë – E premte, 26 prill 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 34/2024, datë 11.4.2024	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e marrëveshjes mbi transportin ndërkombëtar të rastit të udhëtarëve me autobus (Marrëveshja Interbus), në lidhje me transportin ndërkombëtar të rregullt dhe të rregullt të specializuar të udhëtarëve me autobus.....	8087
Dekret i Presidentit nr. 155, datë 22.4.2024	Për shpallje ligji.....	8104
Ligj nr. 35/2024, datë 11.4.2024	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian "Programi i tregut të përbashkët për periudhën 2021–2027".....	8104
Dekret i Presidentit nr. 156, datë 22.4.2024	Për shpallje ligji.....	8125
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 249, datë 24.4.2024	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Mbrojtjes tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të pronës me emërtim "Agjencia Petrelë", me vendndodhje në Petrelë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 413, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit)", të ndryshuar, si dhe për kalimin në përgjegjësi administrimi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit të pronës së paluajtshme të shtetit, ndodhur në zonën kadastrale 2947, pjesë e pasurisë me nr. 444/16.....	8125
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 250, datë 24.4.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 535, datë 13.9.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit 'Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura Himarë dhe largimi i ujërave të trajtuara në det për ITUN Himarë'".....	8128

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 251, datë 24.4.2024	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, për marrëveshjen Istisna'a dhe marrëveshjen e agjencisë Istisna'a, për ndërtimin e segmentit Qukës–Qafë Plloçë, si pjesë e korridorit rrugor Tiranë–Korçë, ratifikuar me ligjin nr. 128/2013, dhe marrëveshjen ndryshuese të marrëveshjes Istisna'a dhe të marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së agjencisë Istisna'a, për ndërtimin e segmentit Qukës–Qafë Plloçë, si pjesë e korridorit rrugor Tiranë–Korçë, ratifikuar me ligjin nr. 73/2022.....	8130
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 24.4.2024	Për një ndryshim në vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare"	8138
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 253, datë 24.4.2024	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të pronës me sipërfaqe 9 600 m^2, me numër pasurie 174/144, e ndodhur në zonën kadastrale 3266.....	8139
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 254, datë 24.4.2024	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme, duke vepruar nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, në mbështetje për gatishmërinë dhe reagimin e shërbimit emergjent shëndetësor, faza kryesore, një projekt dypalësh bashkëpunimi dhe zhvillimi.....	8143
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 24.4.2024	Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2024.....	8147
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe i ministrit të Financave nr. 8, datë 19.3.2024	Për një ndryshim dhe shtesë në udhëzimin nr. 19, datë 22.11.2022, "Për tarifat e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet vartëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural".....	8150

LIGJ
Nr. 34/2024

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN E MARRËVESHJES MBI TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR TË RASTIT TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS (MARRËVESHJA INTERBUS), NË LIDHJE ME TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR TË RREGULLT DHE TË RREGULLT TË SPECIALIZUAR TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin e marrëveshjes mbi transportin ndërkombëtar të rastit të udhëtarëve me autobus (Marrëveshja Interbus), në lidhje me transportin ndërkombëtar të rregullt dhe të rregullt të specializuar të udhëtarëve me autobus, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.4.2024.

Shpallur me dekretin nr. 155, datë 22.4.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

PROTOKOLL I MARRËVESHJES
MBI TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR TË RASTIT TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS (MARRËVESHJA INTERBUS), NË LIDHJE ME TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR TË RREGULLT DHE TË RREGULLT TË SPECIALIZUAR TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS

Palët kontraktuese,

duke marrë në konsideratë

dëshirën për të promovuar dhe për të zhvilluar më tej transportin ndërkombëtar të udhëtarëve në Evropë dhe për të lehtësuar dhe organizimin dhe operimin e tij;

duke marrë në konsideratë rëndësinë e shtuar të turizmit dhe dëshirën për të promovuar më tej shkëmbimin kulturor ndërmjet Palëve Kontraktuese të këtij Protokolli;

duke marrë në konsideratë Marrëveshjen për transportin ndërkombëtar të rastit të udhëtarëve me autobus (Marrëveshja Interbus)[1], siç është ndryshuar më pas, e cila ka hyrë në fuqi më 1 janar 2003[2];

duke marrë në konsideratë dëshirën për të zgjeruar qëllimin e shërbimeve të transportit të përcaktuar në Marrëveshjen Interbus, për të mbuluar, gjithashtu, shërbimet e rregullta dhe të rregullta të specializuara që janë objekt i disa kushteve,

ndërsa:

1. Qëllimi i Marrëveshjes Interbus duhet të zgjerohet me anë të dispozitave që përcaktojnë procedura për shërbimet e rregullta dhe të rregullta të specializuara që janë objekt autorizimi.

2. Ky Protokoll që përmban këto dispozita, duhet të jetë i hapur për aderim për Palët Kontraktuese të Marrëveshjes Interbus.

3. Përveç marrëveshjeve të partneritetit, aktualisht liberalizimi i shërbimeve të rregullta dhe të rregullta të specializuara, që i nënshtrohen autorizimit, duhet të zbatohet vetëm për shërbimet me origjinë ose destinacion në Palën Kontraktuese të themelimit/vendosjes së operatorit të transportit rrugor, ku janë regjistruar automjetet e operatorit.

4. Ndërsa, mundësia për të kryer shërbime të rregullta ose të rregullta të specializuara me origjinë dhe me destinacion në të njëjtën Palë Kontraktuese nga operatorët e vendosur në një Palë tjetër Kontraktuese duhet të përjashtohet, këta operatorë

[1] OJ L 321, 26.11.2002, f. 13.

[2] OJ L 321, 26.11.2002, f. 44

transporti duhet të lejohen të marrin ose të zbresin udhëtarët në pikat e paracaktuara të ndalimit, si pjesë e një shërbimi, për sa kohë nuk transportojnë udhëtarë midis dy ndalimeve brenda një Pale Kontraktuese, e cila nuk është Pala Kontraktuese e themelimit/vendosjes së tyre.

5. Parimi i mosdiskriminimit në bazë të shtetësisë ose vendit të themelimit/vendosjes së operatorit të transportit dhe origjinës ose destinacionit të autobusit dhe shërbimit të ofruar duhet të zbatohet si bazë për ofrimin e shërbimeve ndërkombëtare të transportit rrugor të udhëtarëve.

6. Është e nevojshme që të sigurohen modele uniforme të formularit të aplikimit dhe të autorizimit për shërbimet ndërkombëtare të rregullta dhe të rregullta të specializuara, me qëllim lehtësimin dhe thjeshtimin e procedurave. Duhet të specifikohen dokumentet që shërbejnë si kritere kontrolli dhe që duhet të mbahen në automjet dhe të paraqiten me kërkesën e çdo zyrtari inspektimi të autorizuar, në përputhje me këtë Protokoll, me qëllim që të shmangen interpretimet e ndryshme.

7. Autorizimi për shërbime ndërkombëtare rrugore të rregullta dhe të rregullta të specializuara të udhëtarëve, i miratuar nga autoritetet kompetente të të gjitha Palëve përkatëse Kontraktuese, ose Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian të origjinës dhe të destinacionit të shërbimit dhe ato përgjatë rrugës, në përputhje me "procedurat e autorizimit", dhe i lëshuar nga autoriteti autorizues i origjinës ose i destinacionit të shërbimit, duhet të lejojë operatorin aplikues të vendosur në Palën Kontraktuese të origjinës ose i destinacionit të shërbimit ose operatorin e vendosur në Palën Kontraktuese të origjinës ose i destinacionit dhe të besuar nga operatorët e tjerë për këto qëllime ose në rastin e një partneriteti apo grupi për të kryer shërbimin midis origjinës dhe destinacionit të itinerarit. Ky autorizim duhet të përbëjë autorizimin e vetëm të nevojshëm për kryerjen e shërbimit. Nuk ka nevojë për autorizime të veçanta për të kaluar Palët Kontraktuese ose Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian ose kufirin e tyre si pjesë e shërbimit, pavarësisht nëse udhëtarët kanë hipur apo zbritur në Palën Kontraktuese ose në Shtetin Anëtar të Bashkimit Evropian përgjatë rrugës.

8. Në bazë të kushteve të caktuara, një Palë Kontraktuese ose një Shtet Anëtar i Bashkimit Evropian duhet të lejohet të vendosë që shërbimet ndërkombëtare të rregullta ose të rregullta të specializuara me origjinë ose me destinacion në territorin e saj, duhet të jenë objekt i marrëveshjeve të partneritetit midis operatorëve të origjinës dhe të destinacionit të atij shërbimi. Operatorët e vendosur në Palët Kontraktuese ose Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian nëpër territoret e të cilave kalon shërbimi, duke marrë ose zbritur udhëtarë, duhet të kenë të drejtën për t'u bërë pjesë e këtyre partneriteteve.

9. Duhet të krijohet një Komitet i Përbashkët për menaxhimin e këtij Protokolli, me qëllim që të sigurohet zbatimi i duhur dhe uniform dhe të përshtaten shtojcat, me qëllim që të pasqyrojnë përparimin teknik dhe legjislativ.

10. Është e nevojshme që Palët Kontraktuese të zbatojnë masa uniforme sociale, në lidhje me punën e ekuipazheve të autobusëve të angazhuar në transportin ndërkombëtar rrugor, të drejtuara nga rregullat e sanksionuara në Marrëveshjen Interbus, së cilës i referohet ky Protokoll.

11. Kushtet në të cilat kryhen shërbimet e rregullta dhe të rregullta të specializuara duhet të drejtohen nga rregullat e sanksionuara në Marrëveshjen Interbus, së cilës duhet t'i referohet ky Protokoll, në përputhje me rregullat specifike, siç përcaktohet në aneksin 1 të këtij Protokolli.

12. Harmonizimi i kushteve teknike që zbatohen për autobusët që kryejnë shërbime ndërkombëtare ndërmjet Palëve Kontraktuese, duhet të drejtohet nga rregullat e përcaktuara në Marrëveshjen Interbus, së cilës duhet t'i referohet ky Protokoll, siç përcaktohet në aneksin 2 të këtij Protokolli,

u vendos të përcaktohen rregulla të njëjta për transportin ndërkombëtar të rregullt dhe të rregullt të specializuar të udhëtarëve me autobus, dhe

u ra dakord për sa më poshtë:

SEKSIONI I
QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1
Qëllimi

l. Ky Protokoll zbatohet për:

a) transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve të çdo kombësie, me anë të shërbimeve të rregullta dhe të rregullta të specializuara me autobus:

i. ndërmjet territoreve të të dyja Palëve Kontraktuese dhe nëse do të lindë nevoja gjatë shërbimeve të tilla, në tranzit nëpërmjet territorit të

një Pale tjetër Kontraktuese apo nëpërmjet territorit të një Shteti jokontraktues;

ii. të kryera nga një ose më shumë operator transporti për të tretë ose me qira ose kundrejt një shpërblimi të caktuar, të vendosur në Palën Kontraktuese të origjinës ose destinacionit të shërbimit dhe në rastin e një partneriteti, gjithashtu, një ose më shumë operatorë vendosur në Palët Kontraktuese ose Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, nëpërmjet të cilave kalon shërbimi ku merren ose zbresin udhëtarë, nëse ato vendosin kështu, në përputhje me ligjin e zbatueshëm dhe kur kanë licencë për të kryer transportin e udhëtarëve me anë të shërbimeve ndërkombëtare të rregullta ose të rregullta të specializuara me autobus;

iii. duke përdorur autobusë të regjistruar në Palën Kontraktuese, ku është vendosur operatori i transportit;

b) udhëtimet bosh të autobusëve që merren me këto lloj shërbimesh.

2. Asnjë nga dispozitat e këtij Protokolli nuk duhet të nënkuptohet si një mundësi operimi e shërbimeve të rregullta ose të rregullta të specializuara me origjinë dhe destinacion në të njëjtën Palë Kontraktuese nga operatorë të vendosur në një tjetër Palë Kontraktuese (kabotazh).

3. Në përputhje me paragrafin 1 dhe në bazë të paragrafit 2, kur transporti është pjesë e një shërbimi për në ose nga territori në të cilin është vendosur operatori i transportit, udhëtarët mund të merren ose zbriten në territorin e çdo Pale Kontraktuese gjatë itinerarit, që autorizon një ndalesë në territorin e saj.

4. Ky Protokoll nuk zbatohet, për:

a) përdorimin e autobusëve, që janë caktuar për të mbajtur udhëtarë për transportin e mallrave për qëllime tregtare;

b) shërbime për llogari të vet.

Neni 2
Mosdiskriminimi

Palët Kontraktuese duhet të garantojnë zbatimin e parimeve të mosdiskriminimit, për shkak të kombësisë, vendit ku është vendosur operatori i transportit, vendit të origjinës, si dhe vendit të destinacionit të autobusit dhe shërbimit të ofruar, për këtë Protokoll.

Neni 3
Përkufizime

1. Për qëllime të këtij Protokolli, zbatohen përcaktimet në nenin 3 të Marrëveshjes Interbus.

2. Pa cenuar paragrafin 1, për qëllime të këtij Protokolli do të zbatohen përcaktimet e mëposhtme shtesë:

a) "Marrëveshja lnterbus" nënkupton marrëveshjen për transportin ndërkombëtar të rastit të udhëtarëve me autobus[3], e cila ka hyrë në fuqi më 1 janar 2003[4], siç është ndryshuar në vijim;

b) "partneritet" nënkupton çdo marrëveshje ose marrëveshje të tjera kontraktuale të çfarëdo lloji, sipas së cilës palët e saj, të njohura si partnerë, angazhohen të bashkëpunojnë në lidhje me shërbimin që duhet të ofrohet;

c) "ndërmarrje e bashkuar" nënkupton një ndërmarrje, në të cilën kanë interes për të marrë pjesë një ose më shumë ndërmarrje (ndërmarrja mëmë ose ndërmarrjet) dhe mbi politikat operative dhe financiare, ajo ndërmarrje tjetër, apo ato ndërmarrje të tjera, ushtrojnë ndikim të konsiderueshëm;

d) "grup" nënkupton një nga sa më poshtë:

- një ose më shumë ndërmarrje të bashkuara dhe ndërmarrja e tyre mëmë ose ndërmarrjet;

- një ose më shumë ndërmarrje të bashkuara, të cilat kanë të njëjtën ndërmarrje mëmë ose ndërmarrjet.

SEKSIONI II
KUSHTET E VENDOSURA PËR OPERATORËT E TRANSPORTIT RRUGOR TË UDHËTARËVE

Neni 4

Palët Kontraktuese duhet të zbatojnë dispozitat e përmendura në shtojcën 1.

SEKSIONI III
KUSHTET TEKNIKE QË ZBATOHEN PËR AUTOMJETET

Neni 5

Autobusët e përdorur për të kryer shërbime ndërkombëtare të rregullta dhe të rregullta të specializuara të mbuluara nga ky Protokoll, do të

[3] OJ L 321, 26.11.2002, f. 11.

[4] OJ L 321, 26.11.2002, f. 44.

përmbushin standardet teknike të përcaktuara në shtojcën 2.

SEKSIONI IV
HYRJA NË TREG

Neni 6
Shërbimet ndërkombëtare të rregullta dhe të rregullta të specializuara që i nënshtrohen autorizimit

1. Shërbimet e rregullta do të jenë të hapura për të gjithë, objekt rezervimi të detyrueshëm, në rastet kur është e përshtatshme.

2. Shërbimet e rregullta dhe të rregullta të specializuara janë objekt i autorizimit në përputhje me seksionin VI.

3. Natyra e rregullt e shërbimit nuk do të ndikohet nga ndonjë rregullim i kushteve të operimit të shërbimit.

4. Organizimi i shërbimeve paralele ose të përkohshme, që i shërbejnë të njëjtit publik si shërbimet e rregullta ekzistuese, mosshërbimi i vendndalimeve të caktuara dhe dhënia e vendndalimeve shtesë në shërbimet e rregullta ekzistuese do të rregullohen nga të njëjtat rregulla si ato që zbatohen për shërbimet e rregullta ekzistuese.

5. Në përputhje me rregullat e zbatueshëm të konkurrencës, një Palë Kontraktuese ose një Shtet Anëtar i Bashkimit Evropian mund të vendosë, rast pas rasti, pa diskriminim, që shërbimet ndërkombëtare të rregullta dhe të rregullta të specializuara të transportit rrugor të udhëtarëve me origjine ose destinacion në territorin e saj, të jenë objekt i marrëveshjeve të partneritetit midis operatorëve të vendosur në Palën Kontraktuese ose në Shtetin Anëtar të Bashkimit Evropian të origjinës dhe destinacionit të atij shërbimi.

Operatorët e vendosur në Palët Kontraktuese dhe Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian që kalohen përgjatë rrugës së shërbimit dhe ku merren apo zbriten udhëtarë, do të kenë të drejtë të jenë pjesë në këto partneritete, nëse ata vendosin.

Palët Kontraktuese dhe Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian në fjalë do të informojnë Komitetin e Përbashkët të themeluar në nenin 18 të këtij Protokolli, për çdo vendim të tillë të marrë me arsyetimet e tyre.

6. Në përputhje me rregullat e zbatueshëm mbi konkurrencën, operatorët mund të krijojnë partneritet, mbi baza vullnetare, për qëllime të kryerjes së shërbimeve të rregullta ose të rregullta të specializuara. Operatorët e mëposhtëm mund të marrin pjesë në këto partneritete:

a) operatorët e vendosur në Palët Kontraktuese ose në Shtetin Anëtar të Bashkimit Evropian të origjinës ose destinacionit të shërbimit;

b) operatorët e vendosur në Palët Kontraktuese dhe Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat kalohen gjatë itinerarit të shërbimit dhe ku merren ose zbriten udhëtarët.

SEKSIONI V
DISPOZITAT SOCIALE, DOGANORE DHE FISKALE

Neni 7

Për këtë Protokoll zbatohet seksioni V (dispozitat sociale) dhe seksioni VI (dispozitat doganore dhe fiskale) i Marrëveshjes lnterbus.

SEKSIONI VI
AUTORIZIMI PËR SHËRBIMET NDËRKOMBËTARE TË RREGULLTA DHE TË RREGULLTA TË SPECIALIZUARA

Neni 8
Natyra e autorizimit

1. Autorizimet për shërbimet ndërkombëtare të rregullta dhe të rregullta të specializuara të udhëtarëve lëshohen nga autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës është vendosur operatori i transportit (në vijim i referuar si "autoriteti autorizues").

2. Në rastin e një operatori të vendosur në Bashkimin Evropian, autoriteti autorizues është autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të origjinës ose të destinacionit.

3. Në rastin e një grupi operatorësh që synojnë të kryejnë shërbime ndërkombëtare të rregullta ose të rregullta të specializuara dhe në rastin e një partneriteti ndërmjet ndërmarrjeve (operatorëve) nga të paktën dy Palë Kontraktuese, në territorin e të cilave merren dhe zbriten udhëtarë, autoriteti autorizues do të jetë autoriteti kompetent të cilit i drejtohet aplikimi, në përputhje me nënparagrafin e dytë të nenit 9(1).

4. Autorizimet lëshohen në emër të operatorit dhe nuk janë të transferueshme. Megjithatë, një operator që ka marrë një autorizim, me pëlqimin e autoritetit autorizues, mund të kryejë shërbimin nëpërmjet një nënkontraktuesi, nëse një mundësi e tillë është në përputhje me ligjin e Palës Kontraktuese. Në këtë rast, emri i nënkontraktuesit dhe roli i tij duhet të specifikohen në autorizim. Nënkontraktuesi duhet të plotësojë kushtet e përmendura në nenet 1, 4, 5 dhe, për sa u përket dispozitave shoqërore, duhet të plotësojë kushtet e përmendura në nenin 7, si edhe në shtojcat 1 dhe 2.

Në rastin e një grupi operatorësh, që synojnë të kryejnë shërbime ndërkombëtare të rregullta dhe të rregullta të specializuara, autorizimi lëshohet në emrat e të gjitha ndërmarrjeve të grupit dhe do të shënohen emrat e të gjithë operatorëve. Autorizimi do t'i jepet ndërmarrjes që është besuar nga operatorët e tjerë, për këto qëllime dhe që e ka kërkuar atë dhe ndërmarrjeve të tjera u jepen kopjet origjinale.

Në rastin e një partneriteti do të lëshohen autorizime origjinale për secilën ndërmarrje partnere, duke shënuar në autorizim emrin e secilës ndërmarrje.

Në rastet kur shërbimet ndërkombëtare të rregullta ose të rregullta të specializuara kryhen nga një grup ose partneritet, siç referohet në nënparagrafin e dytë dhe të tretë, vendimi për ndarjen aktuale të performancës së trafikut midis operatorëve pjesëmarrës do të lihet në zgjedhjen e vetë operatorëve.

5. Periudha e vlefshmërisë së një autorizimi nuk duhet të kalojë pesë vjet. Ajo mund të vendoset për një periudhë më të shkurtër, ose me kërkesë të aplikuesit, ose me pëlqimin e ndërsjellë të autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese në territoret e të cilave merren ose zbriten udhëtarët.

6. Autorizimi duhet të specifikojë pikat e mëposhtme:

a) llojin e shërbimit;

b) itinerarin e shërbimit, duke specifikuar në veçanti pikën e nisjes dhe pikën e mbërritjes;

c) periudhën e vlefshmërisë së autorizimit;

d) ndalesat dhe oraret;

7. Autorizimi do të jetë në përputhje me modelin e përcaktuar në shtojcën 4.

8. Në bazë të nenit 1 (2), autorizimet i japin të drejtën mbajtësit (mbajtësve) të tyre që të kryejë shërbime ndërkombëtare të rregullta dhe/ose të rregullta të specializuara në territoret e të gjitha Palëve Kontraktuese ku kalojnë itineraret e shërbimit.

9. Operatori i një shërbimi të rregullt ose të rregullt të specializuar mund të përdorë automjete shtesë për t'iu përgjigjur situatave të përkohshme dhe të jashtëzakonshme. Automjetet e tilla shtesë mund të përdoren vetëm nën të njëjtat kushte, siç përcaktohet në autorizimin e përmendur në paragrafin 6.

Në këtë rast, përveç dokumenteve të përmendura në nenin 15, operatori duhet të sigurojë që një kopje e kontratës ndërmjet operatorit të shërbimit ndërkombëtar të rregullt ose të rregullt të specializuar dhe ndërmarrjes, që siguron automjetet shtesë, ose një dokument ekuivalent të mbahet në automjet dhe të paraqitet në rast se kërkohet nga çdo zyrtar inspektues i autorizuar.

Neni 9

Paraqitja e aplikimit për autorizim për shërbime ndërkombëtare të rregullta dhe të rregullta të specializuara

1. Aplikimet për autorizim për shërbime ndërkombëtare të rregullta dhe të rregullta të specializuara do t'i paraqiten autoritetit kompetent autorizues nga operatori.

Për çdo shërbim do të paraqitet vetëm një aplikim. Në rastet e referuara në nenin 8 (3), ai do të paraqitet nga operatori i besuar nga operatorët e tjerë për këto qëllime.

Aplikimet duhet t'i drejtohen autoritetit autorizues të Palës Kontraktuese në të cilën është vendosur operatori që paraqet kërkesën.

2. Aplikimet për autorizim do të paraqiten në bazë të modelit të përcaktuar në shtojcën 3.

3. Personat që aplikojnë për autorizim duhet të ofrojnë çdo informacion të mëtejshëm që ata e çmojnë të rëndësishëm ose që kërkohet nga autoriteti autorizues, në veçanti dokumentet e renditura në shtojcën 3.

Neni 10

Procedura e autorizimit

1. Autorizimet do të lëshohen në marrëveshje me autoritetet kompetente të të gjitha Palëve Kontraktuese, në territoret e të cilave merren ose zbriten udhëtarë. Autoriteti autorizues do të

përcjellë te këto autoritete kompetente, si dhe tek autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, territoret e të cilave kalohen pa marrë ose zbritur udhëtarë, një kopje të aplikimit, së bashku me kopjet e çdo dokumenti tjetër përkatës dhe vlerësimin e tij.

Për sa i përket Bashkimit Evropian, autoritetet kompetente të përmendura në nënparagrafin e parë do të jenë ato të Shteteve Anëtare, në territoret e të cilave merren ose zbriten udhëtarë dhe territoret e të cilave kalohen pa marrë ose zbritur udhëtarë.

2. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, marrëveshja e të cilave është kërkuar, njoftojnë autoritetin autorizues për vendimin e tyre, në lidhje me aplikimin brenda katër muajve. Ky afat kohor llogaritet nga data e marrjes së kërkesës për marrëveshje, e cila paraqitet në dokumentin që tregon marrjen e kërkesës. Nëse vendimi i marrë nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese, nga të cilat është kërkuar marrëveshja, është negativ, ky vendim duhet të përmbajë një paraqitje të duhur të arsyeve. Nëse autoriteti autorizues nuk merr përgjigje brenda katër muajve, autoritetet kompetente të konsultuara do të konsiderohen se kanë dhënë pëlqimin e tyre dhe autoriteti autorizues mund të japë autorizimin.

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, territoret e të cilave kalohen pa marrë ose zbritur udhëtarë, mund të njoftojnë autoritetin autorizues për komentet e tyre brenda afatit kohor të përcaktuar në nënparagrafin e parë.

3. Autoriteti autorizues merr vendim për aplikimin jo më vonë se gjashtë muaj nga data e dorëzimit të aplikimit nga transportuesi[5].

4. Autorizimi do të jepet përveç rasteve, kur:

a) aplikanti nuk është në gjendje të ofrojë shërbimin që është objekt i aplikimit me pajisjet që janë në dispozicion të tij;

b) aplikanti nuk ka respektuar legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar mbi transportin rrugor dhe, në veçanti, kushtet dhe kriteret në lidhje me autorizimet për shërbimet ndërkombëtare rrugore të udhëtarëve ose ka kryer shkelje të rënda të legjislacionit të transportit rrugor të një Palë Kontraktuese, në veçanti, në lidhje me rregullat e zbatueshme për automjetet dhe periudhat e drejtimit dhe pushimit për drejtuesit e automjeteve;

c) në rastin e një aplikimi për rinovimin e autorizimit, kushtet e autorizimit nuk janë plotësuar;

d) një Palë Kontraktuese vendos mbi bazën e një analize të hollësishme së shërbimi në fjalë do të cenonte rëndë qëndrueshmërinë e një shërbimi të krahasueshëm të mbuluar nga një ose më shumë kontrata shërbimi publik, në përputhje me ligjin e Palës Kontraktuese, mbi seksionet e drejtpërdrejta në fjalë. Në një rast të tillë, Pala Kontraktuese do të vendosë kritere, mbi baza jodiskriminuese, për të përcaktuar nëse shërbimi i kërkuar do të ndikojë seriozisht në qëndrueshmërinë e shërbimit të krahasueshëm të lartpërmendur dhe do t'ua komunikojë këto kritere Palëve të tjera Kontraktuese të referuara në nenin 10 (1);

e) një Palë Kontraktuese vendos mbi bazën e një analize të hollësishme që qëllimi kryesor i shërbimit nuk është të transportojë udhëtarë ndërmjet vendndalimeve të vendosura në Palët e ndryshme Kontraktuese.

Në rast se një shërbim ndërkombëtar ekzistues me autobus ndikon seriozisht në realizueshmërinë e një shërbimi të krahasueshëm të mbuluar nga një ose më shumë kontrata shërbimi publik, të cilat janë në përputhje me ligjin e një Pale Kontraktuese mbi seksionet e drejtpërdrejta në fjalë, për arsye të jashtëzakonshme, të cilat nuk mund të ishin parashikuar në kohën e dhënies së autorizimit, një Palë Kontraktuese, me pëlqimin e Palëve të tjera Kontraktuese të përmendura në nenin 10 (1), mund të pezullojë ose të tërheqë autorizimin për të ofruar shërbim ndërkombëtar të autobusëve, pasi t'i ketë dhënë transportuesit një njoftim gjashtëmujor.

Fakti që një transportues ofron çmime më të ulëta sesa ato të ofruara nga transportuesit e tjerë rrugorë ose fakti që linja në fjalë tashmë operohet nga transportues të tjerë rrugore, nuk përbën në vetvete arsyetim për refuzimin e aplikimit.

5. Autoriteti autorizues dhe autoritetet kompetente të të gjitha Palëve Kontraktuese të përfshira në procedurën për të arritur marrëveshjen e parashikuar në paragrafin 1, mund të refuzojnë aplikimet vetëm në bazë të arsyeve të parashikuara në këtë Protokoll.

6. Pas përfundimit të procedurës së përcaktuar në paragrafët 1 deri në 5, autoriteti autorizues do të japë autorizimin ose do të refuzojë zyrtarisht aplikimin.

[5] Në këtë nen, "operatorët", gjithashtu referohen si "transportues".

Vendimet që refuzojnë një aplikim duhet të përcaktojnë arsyet ku janë bazuar. Palët Kontraktuese do të sigurojnë që ndërmarrjeve të transportit t'u jepet mundësia për të bërë ankimime, në rast të refuzimit të aplikimit të tyre.

Autoriteti autorizues do të informojë të gjitha autoritetet kompetente të përmendura në paragrafin 1, në lidhje me vendimin e tij dhe do t'u dërgojë atyre një kopje të çdo autorizimi.

Neni 11
Rinovimi dhe ndryshimi i autorizimit

1. Neni 10 zbatohet *mutatis mutandis* për aplikimet për rinovim të autorizimeve ose për ndryshim të kushteve, sipas të cilave duhet të kryhen shërbimet që janë objekt i autorizimit.

2. Në rast të një ndryshimi të vogël të kushteve të operimit, në veçanti rregullimit të intervaleve, tarifave dhe orareve, autoriteti autorizues thjesht duhet t'u bëjë të ditur Palëve të tjera Kontraktuese në fjalë informacionin në lidhje me ndryshimin. Ndryshimi i orareve ose i intervaleve në një mënyrë që ndikon në kohën e kontrollit në kufijtë ndërmjet Palëve Kontraktuese ose në kufijtë e vendeve të treta, nuk do të konsiderohet një ndryshim i vogël.

3. Palët Kontraktuese të interesuara mund të bien dakord që autoriteti autorizues të vendosë vetë për ndryshimet e kushteve në të cilat kryhet një shërbim.

Neni 12
Përfundimi i një autorizimi

1. Një autorizim për një shërbim ndërkombëtar të rregullt ose të rregullt të specializuar do të përfundojë në fund të afatit të vlefshmërisë ose tre muaj, pasi autoriteti autorizues të ketë marrë njoftim nga mbajtësi i tij për qëllimin e tij për të tërhequr shërbimin. Një njoftim i tillë duhet të përmbajë një formulim të duhur të arsyeve të tërheqjes.

2. Kur kërkesa për një shërbim ka pushuar së ekzistuari, periudha e njoftimit e parashikuar në paragrafin 1 do të jetë një muaj.

3. Autoriteti autorizues do të informojë autoritetet kompetente të Palëve të tjera Kontraktuese të interesuara për përfundimin e autorizimit.

4. Mbajtësi i autorizimit njofton përdoruesit e shërbimit në fjalë për tërheqjen e tij një muaj para, me mjete të duhura të publikimit.

Neni 13
Detyrimet e operatorëve të transportit

1. Përveç rasteve të *forcës madhore,* operatori i një shërbimi ndërkombëtar të rregullt ose të rregullt të specializuar do të fillojë shërbimin pa vonesë dhe deri në përfundimin e autorizimit, do të marrë të gjitha masat për të garantuar një shërbim transporti që përmbush standardet e vazhdimësisë, rregullsisë dhe kapacitetit dhe është në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 8 (6).

2. Operatori duhet të paraqesë itinerarin e shërbimit, vendndalimet e autobusit, oraret, tarifat dhe kushtet e transportit, në mënyrë që të sigurojë që një informacion i tillë të jetë në dispozicion të të gjithë përdoruesve.

3. Është e mundur që Palët Kontraktuese të interesuara të bëjnë ndryshime të kushteve të operimit që rregullojnë një shërbim ndërkombëtar të rregullt ose të rregullt të specializuar, me marrëveshje të përbashkët dhe në marrëveshje me mbajtësin e autorizimit.

SEKSIONI VII
DISPOZITAT QË SYNOJNË PAJTUESHMËRINË ME KËTË PROTOKOLL

Neni 14

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të sigurojnë që operatorët e transportit të jenë në përputhje me dispozitat e këtij Protokolli.

Neni 15

1. Pa cenuar nenin 8 (9), autorizimi ose një kopje e vërtetuar e këtij autorizimi për kryerjen e shërbimeve ndërkombëtare të rregullta ose të rregullta të specializuara dhe licenca e operatorit ose një kopje e vërtetuar e kësaj licence për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve, të parashikuara sipas legjislacionin kombëtar ose atij të Bashkimit Evropian, do të mbahen në autobus dhe do të paraqiten me kërkesë të çdo zyrtari inspektues të autorizuar.

2. Pa cenuar paragrafin 1 dhe nenin 8 (9), në rastin e një shërbimi të rregullt të specializuar, kontrata midis organizuesit dhe operatorit të transportit ose një kopje e kësaj kontrate, si dhe një dokument që vërteton se udhëtarët përbëjnë një

kategori të specializuar në përjashtimin e udhëtarëve të tjerë për qëllime të një shërbimi të rregullt të specializuar, shërbejnë, gjithashtu, si dokumente kontrolli, mbahen në automjet dhe duhet të paraqiten me kërkesë të çdo zyrtari inspektimi të autorizuar.

SEKSIONI VIII
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16
Kohëzgjatja e Protokollit – Vlerësimi i funksionimit të Protokollit

l. Ky Protokoll do të lidhet për një periudhë prej pesë vjetësh nga data e hyrjes së tij në fuqi.

2. Kohëzgjatja e këtij Protokolli do të zgjatet automatikisht për periudha të njëpasnjëshme prej pesë vjetësh midis atyre Palëve Kontraktuese që nuk shprehin dëshirën për të mos vepruar kështu. Në raste të tjera, Pala Kontraktuese e interesuar do të njoftojë Sekretariatin e Përgjithshëm të Këshillit të Bashkimit Evropian, i cili do të veprojë si Depozitar i këtij Protokolli ("Depozitari"), për qëllimin e saj për zgjidhjen e protokollit, në përputhje me nenin 31 të Marrëveshjes Interbus.

3. Para përfundimit të çdo periudhe pesëvjeçare, Komiteti i Përbashkët i referuar në nenin 18 të këtij Protokolli do të vlerësojë funksionimin e këtij Protokolli, mundësisht së bashku me vlerësimin e vetë Marrëveshjes Interbus.

Neni 17
Marrëveshjet dypalëshe, ratifikimi ose miratimi dhe Depozitari i Protokollit, hyrja në fuqi e Protokollit, denoncimi dhe gjuhët

1. Dispozitat e neneve 25, 27, 28, 31 dhe 34 të Marrëveshjes Interbus do të zbatohen *mutatis mutandis* për këtë Protokoll, subjekt i modifikimeve të mëposhtme:

a) numrat "katër" dhe "i katërt" të përmendura në nenin 28 (1) të Marrëveshjes Interbus do të zëvendësohen përkatësisht me "tre" dhe "i tretë".

b) ky Protokoll do të hyjë në fuqi, për Palët Kontraktuese që e kanë nënshkruar dhe miratuar ose ratifikuar atë, në ditën e parë të muajit pas muajit në të cilin tri Palë Kontraktuese, përfshirë Bashkimin Evropian, kanë depozituar instrumentet e tyre të miratimit ose të ratifikimit te Depozitari.

2. Dispozitat e këtij Protokolli do të zëvendësojnë ato dispozita përkatëse të marrëveshjeve dypalëshe të lidhura ndërmjet Palëve Kontraktuese dhe ndërmjet Palëve Kontraktuese dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian.

Megjithatë, pavarësisht nenit 25 të Marrëveshjes Interbus, dispozitat përkatëse të marrëveshjeve ekzistuese dypalëshe ndërmjet Palëve Kontraktuese dhe ndërmjet Palëve Kontraktuese dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian mund të mbahen për një periudhë pesëvjeçare të referuar në nenin 8

(5) të këtij Protokolli, të llogaritur nga hyrja në fuqi e këtij Protokolli për Palët Kontraktuese në fjalë.

Neni 18
Komiteti i përbashkët

1. Me qëllim që të lehtësohet menaxhimi i këtij Protokolli është krijuar një Komitet i Përbashkët, si rezultat i këtij dokumenti. Ky komitet do të përbëhet nga përfaqësues të Palëve Kontraktuese.

2. Nenet 23 dhe 24 të Marrëveshjes Interbus do të zbatohen *mutatis mutandis.*

Neni 19
Aderimi në Bashkimin Evropian i një Pale Kontraktuese që nuk është pjesë e Bashkimit Evropian

1. Komiteti i Përbashkët i referuar në nenin 18 duhet të informohet për çdo kërkesë të bërë nga një Palë Kontraktuese ose çdo Shtet i tretë për t'u bërë anëtar i Bashkimit Evropian.

2. Palët Kontraktuese do të njoftohen nga Bashkimi Evropian për çdo aderim në Bashkimin Evropian të një Pale Kontraktuese.

3. Një Palë Kontraktuese e këtij Protokolli që ka aderuar në Bashkimin Evropian do të trajtohet si Shtet Anëtar i Bashkimit Evropian dhe jo si një Palë e veçantë Kontraktuese në këtë Protokoll nga data e një aderimi të tillë.

4.. Palët Kontraktuese do të shqyrtojnë efektin që ky aderim ka për këtë Protokoll në kontekstin e Komitetit të Përbashkët. Komiteti i Përbashkët do të vendosë për çdo rregullim të nevojshëm ose masa tranzitore në lidhje me këtë.

Neni 20
Nënshkrimi

1. Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim në Bruksel pranë Depozitarit, për një periudhë dyvjeçare, duke filluar nga data e miratimit të vendimit të Këshillit (BE) 2020/1705[6] për nënshkrimin e këtij Protokolli nga Bashkimi Evropian. Depozitari do t'ua njoftojë këtë datë të gjitha Palëve Kontraktuese në kohën e duhur.

2. Vetëm Palët Kontraktuese të Marrëveshjes Interbus mund të nënshkruajnë dhe të ratifikojnë këtë Protokoll. Instrumentet e miratimit ose të ratifikimit do të depozitohen pranë Depozitarit, i cili do të informojë Palët e tjera Kontraktuese në lidhje me këtë.

Neni 21
Aderimi

Pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, çdo Palë Kontraktuese e Marrëveshjes Interbus, gjithashtu, mund të aderojë në këtë Protokoll.

Instrumenti i aderimit në këtë Protokoll do të depozitohet te Depozitari. Neni 30 (3) dhe (4) i Marrëveshjes Interbus do të zbatohet *mutatis mutandis*.

Neni 22
Shtojcat

Shtojcat e këtij Protokolli do të jenë pjesë integrale e këtij dokumenti.

Neni 23
Zëvendësimi i Protokollit të mëparshëm

Ky Protokoll zëvendëson Protokollin e Marrëveshjes mbi transportin ndërkombëtar të rastit të udhëtarëve me autobus (Marrëveshja Interbus), në lidhje me transportin ndërkombëtar të rregullt dhe të rregullt të specializuar të udhëtarëve me autobus, i cili ishte i hapur për nënshkrim ndërmjet 16 korrikut 2018 dhe 16 prillit 2019. Protokolli i mëparshëm nuk do të ketë asnjë vlerë ligjore.

Bërë në Bruksel.

Në dëshmi të kësaj, të plotfuqishmit nënshkrues kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Për Bashkimin Evropian
Për Republikën e Shqipërisë
Për Principatën e Andorrës
Për Bosnjën dhe Hercegovinën
Për Republikën e Moldavisë
Për Malin e Zi
Për Republikën Maqedonisë së Veriut
Për Republikën e Turqisë
Për Ukrainën
Për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut

SHTOJCA 1

Kushtet që zbatohen për operatorët e transportit rrugor të udhëtarëve

Shtojca 1 e Marrëveshjes Interbus do të zbatohet për këtë Protokoll, duke iu nënshtruar pikave të mëposhtme:

Rregullorja (KE) nr. 1071/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 tetor 2009 që përcakton rregullat e përbashkëta, në lidhje me kushtet që duhet të zbatohen për të ushtruar profesionin e operatorit të transportit rrugor dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 96/26/KE (Fletorja Zyrtare L 300, 14.11.2009, f. 51), siç është ndryshuar së fundmi nga Rregullorja e Këshillit (BE) nr. 517/2013, e datës 13 maj 2013 (Fletorja Zyrtare L 158, 10.6.2013, f. 1), do të zbatohet për këtë Protokoll me përjashtim të neneve 16 (5) deri në (7), si edhe të neneve 18 deri 21, 23 dhe 25 deri 28. Të drejtat dhe detyrimet e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian do të zbatohen *mutatis mutandis* për Palët Kontraktuese.

Rregullorja (KE) nr. 181/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 16 shkurt 2011, në lidhje me të drejtat e udhëtarëve në transportin me autobus dhe rregulloret ndryshuese (KE) nr. 2006/2004 (Fletorja Zyrtare L 55, 28.2.2011, f. 1), do të zbatohen për këtë Protokoll, me përjashtim të nenit 3(a) dhe "b", dy fjalive të fundit të nenit 12,

[6] Vendimi i Këshillit (BE) 2020/1705, datë 23 tetor 2020, për nënshkrimin në emër të Bashkimi Evropian të një Protokolli të Marrëveshjes mbi transportin ndërkombëtar të rastit të udhëtarëve me autobus (Marrëveshja Interbus), në lidhje me transportin ndërkombëtar të rregullt dhe të rregullt të specializuar të udhëtarëve me autobus (FZ L385, 17.11.2020, f. 1–2).

nenit 18, nenit 28(2), neneve 29 dhe 30, fjalisë së fundit të nenit 31 dhe nenit 32. Të drejtat dhe detyrimet e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian do të zbatohen *mutatis mutandis* për Palët Kontraktuese.

SHTOJCA 2

Standardet teknike që zbatohen për autobusët

Shtojca 2 e Marrëveshjes Interbus do të zbatohet për këtë Protokoll.

SHTOJCA 3

Modeli i aplikimit për një autorizim

për një shërbim ndërkombëtar të rregullt dhe të rregullt specializuar

(Letër e bardhë – DIN A4)

Të hartohet në gjuhën (gjuhët) zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të palës Kontraktuese ku është bërë kërkesa

FORMULAR APLIKIMI PËR NJË AUTORIZIM OSE RINOVIM TË NJË AUTORIZIMI PËR TË KRYER NJË SHËRBIM NDËRKOMBËTAR TË RREGULLT OSE NJË SHËRBIM NDËRKOMBËTAR TË RREGULLT TË SPECIALIZUAR ([1])

Për të filluar një shërbim të rregullt □

Për të filluar një shërbim të rregullt të specializuar □

Për të rinovuar autorizimin për një shërbim □

Për të ndryshuar kushtet e autorizimit për një shërbim □

të kryer me autobus ndërmjet Palëve Kontraktuese në përputhje me Protokollin mbi transportin ndërkombëtar të rregullt dhe të rregullt të specializuar të udhëtarëve me autobus të Marrëveshjes së transportit ndërkombëtar të rastit të udhëtarëve me autobus (Marrëveshja Interbus).

.....

(Autoriteti autorizues)

[1] Shënjoni ose plotësoni sipas rastit.

1. Emri dhe mbiemri ose emri tregtar i operatorit aplikues; në rastin e një kërkese nga një grup operatorësh ose nga një partneritet, emri i operatorit të mandatuar nga operatorët e tjerë për qëllime të paraqitjes së kërkesës:

.....

.....

2. Shërbimet që do të kryhen [1]

Nga një operator □ nga një grup operatorësh □ nga një partneritet □ nga një nënkontraktor □

3. Emrat dhe adresat e operatorit ose në rastin e një grupi operatorësh ose të një partneriteti, emrat e të gjithë operatorëve të grupit ose të partneritetit; përveç kësaj, çdo nënkontraktor duhet të identifikohet nga emrat e tyre[2]

3.1. ..... tel. .....

3.2. ..... tel. .....

3.3. ..... tel. .....

3.4. ..... tel. .....

[1] Shënjoni ose plotësoni sipas rastit.

[2] Bashkëlidhni listën, nëse është e zbatushme.

(Faqja e dytë e aplikimit për autorizim ose rinovim të autorizimit)

4. Në rastin e një shërbimi të rregullt specializuar:

4.1. Kategoria e udhëtarëve: [1] punëtorë □ nxënës shkolle /studentë □ tjetër □

5. Kohëzgjatja e autorizimit të kërkuar ose data kur mbaron shërbimi:

.....

6. Itinerari kryesor i shërbimit (nënvizoni pikat e marrjes dhe zbritjes së udhëtarëve, me adresat e plota): [2]

.....

.....

.....

7. Periudha e operimit: .....

.....

.....

8. Frekuenca (ditore, javore, etj): .....

9. Tarifat ..... Shtojca bashkëlidhur.

10. Bashkëlidh një program udhëtimi për të lejuar verifikimin e përputhshmërisë me rregullat ndërkombëtare për kohët e drejtimit dhe periudhat e pushimit.

11. Numri i autorizimeve ose i kopjeve të vërtetuara të autorizimeve të kërkuara: [3]

.....

12. Çdo informacion shtesë:

.....

(Vendi dhe data) (Nënshkrimi i aplikantit)

.....

[1] Shënjoni ose plotësoni sipas rastit.

[2] Autoriteti autorizues mund të kërkojë një listë të plotë të pikave të marrjes dhe zbritjes së udhëtarëve me adresat e plota që t'i bashkëlidhet veçmas këtij formulari aplikimi.

[3] Plotësoni siç duhet.

Aplikantit i tërhiqet vëmendje për faktin që, autorizimi ose kopja e vërtetuar e tij duhet të mbahen në bordin e automjetit, numri i autorizimeve ose kopje të vërtetuara, të lëshuara nga autoriteti autorizues, të cilat duhet t'i ketë aplikanti, duhet të korrespondojnë me numrin e automjeteve të nevojshme për kryerjen në të njëjtën kohë të shërbimit të kërkuar.

Shënim i rëndësishëm

Në mënyrë të veçantë, aplikimit duhet t'i bashkëlidhen dokumentet e mëposhtme:

(a) orari i udhëtimit, duke përfshirë intervalin kohor për kontrollet në vendkalimet kufitare përkatëse;

(b) një kopje e certifikuar e licencës (licencave) të operatorit (ose operatorëve) për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve, të parashikuar sipas legjislacionit kombëtar ose atij të Bashkimit Evropian;

(c) një hartë në një shkallë të përshtatshme në të cilën shënohet itinerari dhe pikat e ndalimit ku do të merren ose zbriten udhëtarët;

(d) një program udhëtimi për të lejuar verifikimin e përputhshmërisë me rregullat ndërkombëtare për kohët e drejtimit dhe periudhat e pushimit;

(e) çdo informacion të përshtatshëm në lidhje me terminalet e autobusëve.

SHTOJCA 4

Model autorizimi për një shërbim ndërkombëtar të rregullt dhe të rregullt të specializuar

(Faqja e parë e autorizimit)

(Letër në ngjyrë portokalli – DIN A4)

Të hartohet në gjuhën (gjuhët) zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të palës Kontraktuese ku është bërë kërkesa

Autorizim

Në përputhje me Protokollin mbi transportin ndërkombëtar të rregullt dhe të rregullt të specializuar të udhëtarëve me autobus, ndërmjet Palëve Kontraktuese, të Marrëveshjes për transportin ndërkombëtar të rastit të udhëtarëve me autobus (Marrëveshja Interbus).

SHTETI QË LËSHON AUTORIZIMIN: .....

Autoriteti autorizues: .....

Shenja dalluese e Palës Kontraktuese: ..... [1]

[1] Shqipëria (AL), Andorra (AD), Austria (A), Belgjika (B), Bosnja dhe Hercegovina (BIH), Bullgaria (BG), Qipro (CY), Kroacia (HR), Republika Çeke (CZ), Danimarka (DK), Estonia (EST), Finlanda (FIN), Franca (F), Gjermania (D), Greqia (GR), Hungaria (H), Irlanda (IRL), Italia (I), Latvia (LV), Lituania (LT), Luksemburgu (L), Maqedonia e Veriut (NMK), Malta (MT), Republika e Moldavisë (MD), Mali i Zi (ME), Holanda (NL), Polonia (PL), Portugalia (P), Rumania (RO), Republika Sllovake (SK), Sllovenia (SLO), Spanja (E), Suedia (S), Turqia (TR), Ukraina (UA), Mbretëria e Bashkuar (UK), për tu plotësuar.

AUTORIZIMI Nr.: .....

për një shërbim të rregullt □ [1]

për një shërbim të rregullt të specializuar □ [1]

me autobus ndërmjet Palëve Kontraktuese të Protokollit për transportin ndërkombëtar të rregullt dhe të rregullt të specializuar të udhëtarëve me autobus, (Protokolli i Marrëveshjes Interbus)

Për:

.....

.....

Mbiemri, emri ose emri tregtar i operatorit ose i operatorit menaxhues në rastin e një grupi ndërmarrjesh ose në rastin e një partneriteti:

Adresa: .....

.....

Telefoni dhe faksi ose e-mail: .....

(Faqja e dytë e autorizimit)

Emri, adresa, telefoni dhe faksi ose e-maili i operatorit ose në rastin e grupeve të operatorëve ose partneriteteve, emrat e të gjithë operatorëve të grupit ose të partneritetit; përveç kësaj, emrat e çdo nënkontraktuesi, që do të identifikohen si të tillë:

(1).....

(2).....

(3).....

(4).....

(5).....

[1] Shënjoni ose plotësoni sipas rastit.

Lista bashkëlidhur, nëse është e zbatueshme

Vlefshmëria e autorizimit: Nga: ..... Deri në: .....

Vendi dhe data e lëshimit: .....

Nënshkrimi dhe vula e autoritetit ose agjencisë që lëshon autorizimin:.....

1. Linja:.....

.....

(a) Vendi i nisjes së shërbimit: .....

.....

(b) Vendi i destinacionit të shërbimit: .....

.....

Itinerari kryesor, me pikat e marrjes dhe të zbritjes së udhëtarëve të nënvizuara: .....

.....

2. Orari i udhëtimit : .....

(bashkëlidhur këtij autorizimi)

3. Shërbimi i rregullt i specializuar:

(a) Kategoria e udhëtarëve: .....

.....

4. Kushte të tjera ose pika të veçanta .....

.....

.....

Vula e autoritetit që lëshon autorizimin

Shënim i rëndësishëm:

(1) Ky autorizim është i vlefshëm përgjatë gjithë udhëtimit.

(2) Autorizimi ose një kopje e certifikuar nga autoriteti autorizues që ka lëshuar autorizimin, do të mbahet në automjet përgjatë gjithë udhëtimit dhe duhet t'i paraqitet zyrtarëve ligjzbatues me kërkesë të tyre.

(3) Nisja ose destinacioni do të jenë në territorin e Palës Kontraktuese ku është vendosur operatori dhe ku janë regjistruar autobusët.

(Faqja e tretë e autorizimit)
KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

1. Operatori i transportit do të fillojë shërbimin e transportit brenda periudhës së përcaktuar në vendimin e autoritetit autorizues që jep autorizimin.

2. Me përjashtim të rasteve të *forcës madhore,* operatori i një shërbimi ndërkombëtar të rregullt ose të rregullt të specializuar duhet të marrë të gjitha masat për të garantuar një shërbim transporti, që është në përputhje me kushtet e përcaktuara në autorizim.

3. Operatori duhet të vërë në dispozicion të publikut informacione për itinerarin, pikat e ndalimit, oraret, çmimet dhe kushtet e transportit.

4. Është e mundur që autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese të interesuara, me marrëveshje të përbashkët dhe në marrëveshje me mbajtësin e autorizimit, të kryejnë ndryshime të kushteve të operimit që rregullojnë një shërbim ndërkombëtar të rregullt dhe të rregullt të specializuar.

5. Pa cenuar dokumentet që lidhen me automjetin dhe drejtuesin e mjetit (siç janë certifikata e regjistrimit të automjeteve dhe leja e drejtimit e drejtuesit të mjetit), dokumentet e mëposhtme shërbejnë si dokumente kontrolli sipas këtij Protokolli dhe mbahen në automjet dhe paraqiten me kërkese të çdo zyrtari inspektues të autorizuar:

- autorizimi ose një kopje e certifikuar e autorizimit për kryerjen e shërbimeve ndërkombëtare të rregullta ose të rregullta të specializuara;

- licenca e operatorit ose kopje e certifikuar e licencës së tij për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve, e parashikuar sipas legjislacionit kombëtar ose atij të Bashkimit Evropian;

- kur kryhet një shërbim ndërkombëtar i rregullt i specializuar, kontrata ndërmjet organizatorit dhe operatorit të transportit ose një kopje e certifikuar e kësaj kontrate, si dhe një dokument që vërteton se udhëtarët përbëjnë një kategori të specializuar për përjashtimin e udhëtarëve të tjerë për qëllime të një shërbimi të rregullt të specializuar;

- kur operatori i një shërbimi të rregullt ose të rregullt të specializuar përdor automjete shtesë për të përballuar situata të përkohshme dhe të jashtëzakonshme, përveç dokumenteve përkatëse të lartpërmendura, një kopje e kontratës ndërmjet operatorit të shërbimit ndërkombëtar të rregullt ose të rregullt të specializuar dhe ndërmarrjes që siguron automjetet shtesë ose një dokument i barasvlershëm.

(Faqja e katërt e autorizimit)
KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME (vazhdim)

6. Operatorët që kryejnë një shërbim të rregullt ndërkombëtar, me përjashtim të shërbimit të rregullt të specializuar, lëshojnë bileta transporti që konfirmojnë të drejtat e udhëtarit për t'u transportuar dhe që shërbejnë si dokument kontrolli, që vërteton lidhjen e kontratës së transportit midis udhëtarit dhe operatorit të transportit, qoftë në mënyrë individuale ose kolektive. Biletat, që gjithashtu, mund të jenë elektronike, duhet të specifikojnë:

a) emrin e operatorit;

b) pikat e nisjes dhe të destinacionit dhe, nëse është e zbatueshme, udhëtimin e kthimit;

c) periudhën e vlefshmërisë së biletës dhe, nëse është e zbatueshme, datën dhe orën e nisjes;

d) çmimin e transportit.

Bileta e transportit do të paraqitet nga udhëtari, në rast se kërkohet nga ndonjë zyrtar inspektimi i autorizuar.

7. Operatorët që kryejnë shërbime ndërkombëtare të rregullta ose të rregullta të specializuara të transportit të udhëtarëve do të lejojnë të gjitha inspektimet, që synojnë të sigurojnë që operimi po kryhet në mënyrën e duhur, veçanërisht në lidhje me periudhat e drejtimit të automjetit dhe me periudhat e pushimit dhe sigurinë rrugore, dhe emetimet.

DEKRET
Nr. 155, datë 22.4.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 34/2024, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e marrëveshjes mbi transportin ndërkombëtar të rastit të udhëtarëve me autobus (Marrëveshja Interbus), në lidhje me transportin ndërkombëtar të rregullt dhe të rregullt të specializuar të udhëtarëve me autobus".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 35/2024

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN PËR PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E BASHKIMIT EVROPIAN "PROGRAMI I TREGUT TË PËRBASHKËT PËR PERIUDHËN 2021–2027"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian "Programi i tregut të përbashkët për periudhën 2021–2027", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.4.2024.

Shpallur me dekretin nr. 156, datë 22.4.2024, të Prestidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NGA NJËRA ANË, DHE BASHKIMIT EVROPIAN, NGA ANA TJETËR, PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E BASHKIMIT EVROPIAN PËR PROGRAMIN E TREGUT TË PËRBASHKËT (*SINGLE MARKET PROGRAMME*)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë (në vijim e referuar si "Shqipëria"),
nga njëra anë, dhe
Komisioni Evropian (në vijim i referuar si "Komisioni"), në emër të Bashkimit Evropian,
nga ana tjetër,
në vijim të referuara si "Palët",
duke pasur parasysh se një Marrëveshje Kuadër është nënshkruar më 22 nëntor 2004 ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë[7], e cila përcakton parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Unionit. Neni 5 i Marrëveshjes Kuadër parashikon që termat dhe kushtet specifike, duke përfshirë kontributin financiar, në lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë në çdo program të veçantë, do të përcaktohen nga Komisioni dhe Qeveria e Shqipërisë.
duke pasur parasysh se Programi i Unionit-Programi i Tregut të Përbashkët u krijua me rregulloren (BE) 2021/690 të Parlamentit Evropian

[7] OJ L 192, 22.7.2005, f. 2.

dhe të Këshillit[8] (në vijim i referuar si "Programi i Tregut të Përbashkët");

duke pasur parasysh se termat dhe kushtet specifike të asociimit duhet të përcaktohen nga një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Unionit dhe vendit të asociuar;

duke njohur parimet e përgjithshme të përcaktuara në rregulloren (BE) 2021/690 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;

duke pasur parasysh se sipas rregullores (BE) 2021/690 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, vendet aderuese, vendet kandidate dhe kandidatët potencialë dhe vendet e Politikës Evropiane të Fqinjësisë mund të marrin pjesë në përputhje me parimet e përgjithshme dhe termat dhe kushtet e përgjithshme për pjesëmarrjen e këtyre vendeve në programet e Unionit, të krijuara në marrëveshjet kuadër përkatëse dhe vendimet e Këshillit të Asociimit ose në marrëveshje të ngjashme, dhe në përputhje me kushtet specifike të përcaktuara në marrëveshjet ndërmjet Unionit dhe atyre vendeve;

duke pranuar objektivat e Programit të Tregut të Përbashkët për të përmirësuar funksionimin e tregut të brendshëm dhe, veçanërisht, për të mbrojtur dhe fuqizuar qytetarët, konsumatorët dhe bizneset, në veçanti NVM-të, duke zbatuar ligjin e Unionit, lehtësuar aksesin në treg, vendosur standarde dhe promovuar mirëqenien dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, si dhe mirëqenien e kafshëve, ndërsa respektohen parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe garantohet një nivel i lartë i mbrojtjes së konsumatorit, si dhe për të zhvilluar, prodhuar dhe shpërndarë statistika evropiane me cilësi të lartë, të krahasueshme, në kohë dhe të besueshme, të cilat mbështesin hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e të gjitha politikave të Unionit dhe për të ndihmuar qytetarët, politikëbërësit, autoritetet, bizneset, mjedisin akademik dhe median, që të marrin vendime të informuara dhe të marrin pjesë aktivisht në procesin demokratik;

duke njohur dëshirën e përbashkët të Palëve për të zhvilluar, forcuar, stimuluar dhe zgjeruar më tej marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e tyre,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Objekti i asociimit

Shqipëria do të marrë pjesë si vend i asociuar dhe do të kontribuojë në objektivin specifik që korrespondon me nënparagrafin 2(b), forcimin e konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së NMV-ve dhe arritjen e shtesës në nivel të Unionit, të Programit të Tregut të Përbashkët, siç përmendet në nenin 3 të rregullores (BE) 2021/690 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit[9] në versionin më të përditësuar.

Neni 2
Termat dhe kushtet e pjesëmarrjes në Programin e Tregut të Përbashkët

1. Shqipëria do të marrë pjesë në Programin e Tregut të Përbashkët në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Komunitetit dhe sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, në aktin ligjor të përmendur në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, si dhe në çdo rregull tjetër të lidhur me zbatimin e Programit të Tregut të Përbashkët, në versionet e tyre më të përditësuara.

2. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në termat dhe kushtet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, personat juridikë të themeluar në Shqipëri mund të marrin pjesë në veprimet e Programit të Tregut të Përbashkët sipas kushteve të barabarta me ato të zbatueshme për personat juridikë të themeluar

[8] Rregullorja (BE) 2021/690 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 28 prill 2021, për krijimin e një programi për tregun e brendshëm, konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve, përfshirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, fushën e bimëve, kafshëve, ushqimit dhe ushqimit për kafshë, dhe statistikat evropiane (Programi i Tregut të Përbashkët) dhe rregulloret shfuqizuese (BE) nr. 99/2013, (BE) nr. 1287/2013, (BE) nr. 254/2014 dhe (BE) nr. 652/2014, OJ L 153, 3.5.2021 , f. l.

[9] Rregullorja (BE) 2021/690 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 28 prill 2021, për krijimin e një programi për tregun e brendshëm, konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve, përfshirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, fushën e bimëve, kafshëve, ushqimit dhe ushqimit për kafshë, dhe statistikat evropiane (Programi i Tregut të Përbashkët) dhe rregulloret shfuqizuese (BE) nr. 99/2013, (BE) nr. 1287/2013, (BE) nr. 254/2014 dhe (BE) nr. 652/2014 (OJ L 153, 3.5.2021, f. 1.).

në Union, përfshirë respektimin për masat kufizuese të BE-së[10].

3. Përfaqësuesit e Shqipërisë kanë të drejtë të marrin pjesë si vëzhgues në komisionet e përmendura në nenin 21.1 të rregullores (BE) 2021/690 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, pa të drejtë vote dhe për pikat e lidhura me Shqipërinë. Komisioni mblidhet pa praninë e përfaqësuesve të Shqipërisë në kohën e votimit. Shqipëria do të informohet për rezultatin.

4. Kostot e udhëtimit dhe shpenzimet e jetesës për përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për qëllime të pjesëmarrjes si vëzhgues në punën e komisioneve të përmendura në nenin 21.1 të rregullores (BE) 2021/690 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ose në takime të tjera që lidhen me zbatimin e Programit të Tregut të Përbashkët, do të rimbursohen nga Bashkimi Evropian mbi të njëjtën bazë dhe në përputhje me procedurat në fuqi për përfaqësuesit e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian.

5. Shqipëria do të marrë të gjitha masat e nevojshme, sipas rastit, për të garantuar që mallrat dhe shërbimet, të blera në Shqipëri ose të importuara në Shqipëri, të cilat financohen pjesërisht ose tërësisht në përputhje me marrëveshjet e grantit dhe/ose kontratat e lidhura për realizimin e aktiviteteve në përputhje me këtë Marrëveshje, të përjashtohen nga detyrimet doganore, detyrimet e importit dhe tarifat e tjera fiskale, përfshirë TVSH-në, që janë të zbatueshme në Shqipëri.

Neni 3
Kontributi financiar

1. Pjesëmarrja e Shqipërisë ose e personave juridikë të Shqipërisë në Programin e Tregut të Përbashkët do t'i nënshtrohet dhënies së kontributit financiar të Shqipërisë në program dhe kostot e lidhura me menaxhimin, ekzekutimin dhe funksionimin në kuadër të buxhetit të përgjithshëm të Unionit (në vijim i referuar si "Buxheti i Unionit").

2. Kontributi financiar do të marrë formën e shumës së:

a) një kontributi operacional; dhe

b) një tarife pjesëmarrjeje.

3. Kontributi financiar do të marrë formën e një pagese vjetore të kryer me një këst dhe do të jetë i kërkueshëm jo më vonë se deri në muajin maj.

4. Kontributi operacional do të mbulojë shpenzimet operative dhe mbështetëse të programit dhe do të jetë shtesë si në ndarjet buxhetore edhe të pagesave ndaj shumave të regjistruara në buxhetin e Unionit, të miratuara përfundimisht për Programin e Tregut të Përbashkët.

5. Kontributi fillestar operacional bazohet në një çelës kontributi të përcaktuar si raporti i prodhimit të brendshëm bruto (PBB) të Shqipërisë me çmimet e tregut ndaj PBB-së së Unionit me çmimet e tregut. PBB-të me çmimet e tregut që do të aplikohen, do të përcaktohen nga shërbimet e dedikuara të Komisionit bazuar në të dhënat më të fundit statistikore të disponueshme për llogaritjet e buxhetit në vitin para vitit në të cilin është e kërkueshme pagesa vjetore. Rregullimet për këtë çelës kontributi janë përcaktuar në aneksin I.

6. Kontributi fillestar operacional do të llogaritet duke aplikuar çelësin e kontributit, i rregulluar, në ndarjet fillestare buxhetore të regjistruara në buxhetin e Unionit, të miratuara përfundimisht për vitin e zbatueshëm për financimin e Programit të Tregut të Përbashkët.

7. Tarifa e pjesëmarrjes do të jetë 4% e kontributit fillestar vjetor operacional, siç llogaritet në përputhje me paragrafët 5 dhe 6 dhe do të ndahet në faza siç përcaktohet në aneksin I. Tarifa e pjesëmarrjes nuk do t'i nënshtrohet rregullimeve ose korrigjimeve retrospektive.

8. Unioni do t'i ofrojë Shqipërisë informacion në lidhje me pjesëmarrjen e saj financiare siç përfshihet në informacionin buxhetor, kontabël, performancën dhe vlerësimin që u jepet autoriteteve përkatëse përgjegjëse për buxhetin dhe dhënien e miratimin përfundimtar për zbatimin e buxhetit për vitin në fjalë, në mbyllje të vitit financiar të Unionit në lidhje me Programin e Tregut të Përbashkët. Ky informacion do të jepet duke pasur parasysh rregullat e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë dhe

[10] Masat kufizuese të BE-së janë masa kufizuese të miratuara në bazë të Traktatit për Bashkimin Evropian ose Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian.

nuk cenon informacionin që Shqipëria ka të drejtë të marrë sipas aneksit II.

9. Të gjitha kontributet e Shqipërisë ose pagesat nga Unioni, si dhe llogaritja e shumave të kërkueshme ose që do të merren, do të bëhen në monedhën euro.

Neni 4
Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi

1. Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit, Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) dhe Gjykatës së Audituesve të Bashkimit Evropian në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e Programit të Tregut të Përbashkët, pjesëmarrja e Shqipërisë në atë program do të monitorohet vazhdimisht mbi një bazë partneriteti që përfshin Komisionin dhe Shqipërinë.

2. Rregullat në lidhje me menaxhimin e qëndrueshëm financiar, përfshirë kontrollin financiar, rikuperimin dhe masat e tjera kundër mashtrimit në lidhje me financimin e Unionit sipas kësaj Marrëveshjeje, përcaktohen në aneksin II.

Neni 5
Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme të nevojshme për këtë qëllim.

2. Kjo Marrëveshje do të zbatohet nga 1 janari 2021. Ajo do të mbetet në fuqi për aq kohë sa është e nevojshme për të gjitha projektet dhe veprimet, aktivitetet ose pjesë të tyre të financuara nga Programi i Tregut të Përbashkët, të gjitha veprimet e nevojshme për të mbrojtur interesat financiare të Bashkimit Evropian dhe të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje ndërmjet Palëve, të cilat duhet të plotësohen.

3. Bashkimi Evropian dhe Shqipëria mund ta zbatojnë këtë Marrëveshje përkohësisht në përputhje me procedurat dhe legjislacionin e tyre të brendshëm përkatës. Zbatimi i përkohshëm do të fillojë në datën kur Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme të nevojshme për atë qëllim.

4. Nëse Shqipëria njofton Komisionin që vepron në emër të Unionit se nuk do të përfundojë procedurat e saj të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshje do të pushojë së zbatuari përkohësisht në datën e marrjes së këtij njoftimi nga Komisioni, e cila do të përbëjë datën e ndërprerjes për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

5. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje mund të pezullohet nga Bashkimi Evropian në rast të mospagesës së kontributit financiar ose operacional të kërkueshëm nga Shqipëria në përputhje me pikën II të paragrafit 3 të aneksit I.

Në rast të mospagesës, e cila mund të rrezikojë ndjeshëm zbatimin dhe menaxhimin e Programit të Tregut të Përbashkët, Komisioni do të dërgojë një letër zyrtare kujtese. Kur nuk kryhet asnjë pagesë brenda 20 ditë-pune pas letrës zyrtare të kujtesës, pezullimi i zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do t'i njoftohet Shqipërisë nga Komisioni me një letër zyrtare njoftimi, e cila do të hyjë në fuqi 15 ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga Shqipëria.

Pezullimi i zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do t'i njoftohet Shqipërisë nga Bashkimi Evropian me një letër zyrtare njoftimi, e cila do të hyjë në fuqi 15 ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga Shqipëria.

Në rast se zbatimi i kësaj Marrëveshjeje pezullohet, personat juridikë të themeluar në Shqipëri nuk do të kenë të drejtë të marrin pjesë në procedurat e dhënies së kontratës që nuk kanë përfunduar ende kur pezullimi të hyjë në fuqi. Një procedurë e dhënies së kontratës do të konsiderohet e përfunduar kur si rezultat i kësaj procedure janë marrë angazhime ligjore.

Pezullimi nuk cenon angazhimet ligjore të bëra me personat juridikë të themeluar në Shqipëri përpara hyrjes në fuqi të pezullimit. Kjo Marrëveshje do të vazhdojë të zbatohet për këto angazhime ligjore.

Bashkimi Evropian do të njoftojë menjëherë Shqipërinë pasi të jetë marrë prej saj e gjithë shuma e kontributit të kërkueshëm financiar ose operacional. Pezullimi do të hiqet me efekt të menjëhershëm pas këtij njoftimi.

Që nga data e heqjes së pezullimit, personat juridikë të Shqipërisë do të jenë sërish të pranueshëm në procedurat e dhënies së kontratës, të filluara pas kësaj date dhe në procedurat e dhënies së kontratës, të filluara përpara kësaj date, për të cilat nuk kanë skaduar afatet për paraqitjen e aplikimeve.

6. Secila palë mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje në çdo kohë me një njoftim me shkrim që informon për qëllimin për ta ndërprerë atë.

Ndërprerja do të hyjë në fuqi tre muaj kalendarikë pas datës kur marrësi merr njoftimin me shkrim. Data në të cilën përfundimi hyn në fuqi do të përbëjë datën e ndërprerjes për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

7. Kur kjo Marrëveshje pushon së zbatuari përkohësisht në përputhje me paragrafin 4 ose ndërpritet në përputhje me paragrafin 6, Palët bien dakord, që:

a) projektet ose veprimet, aktivitetet ose pjesë të tyre në lidhje me të cilat janë marrë angazhime ligjore gjatë zbatimit të përkohshëm dhe/ose pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe përpara se kjo Marrëveshje të pushojë së zbatuari ose të ndërpritet, do të vazhdojnë deri në plotësimin e tyre sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje;

b) kontributi financiar vjetor i vitit N, gjatë të cilit kjo Marrëveshje pushon së zbatuari përkohësisht ose ndërpritet, do të paguhet në përputhje me nenin 3.

Palët do të zgjidhin me pëlqim të përbashkët çdo pasojë tjetër të përfundimit ose ndërprerjes së zbatimit të përkohshëm të kësaj Marrëveshjeje.

8. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqimin e përbashkët të Palëve. Hyrja në fuqi e ndryshimeve do të ndjekë të njëjtën procedurë si ajo e zbatueshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

9. Anekset e kësaj Marrëveshjeje përbëjnë pjesë integrale të saj.

10. Gjuha angleze do të përdoret për procedurat që lidhen me kërkesat, kontratat dhe raportet, si dhe për aspekte të tjera administrative të Programit të Tregut të Përbashkët.

Kjo Marrëveshje do të hartohet në dy kopje në gjuhën angleze dhe shqipe, ku secili tekst është njëlloj autentik. Në rast të mospërputhjes në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Nënshkruar në Bruksel, më 19 dhjetor 2023.

Për Republikën e Shqipërisë:	*Për Komisionin, në emër të Bashkimit Evropian:*
Endrit Yzeiraj	**Kerstin Jorna**
Zëvendësministër	Drejtore e përgjithshme
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Drejtoria e Përgjithshme për Tregun e Brendshëm, Industrinë, Sipërmarrjen dhe NMV-të

ANEKSI I: Rregullat që rregullojnë kontributin financiar të Shqipërisë në Programin e Tregut të Përbashkët (2021–2027)

ANEKSI II: Menaxhimi i qëndrueshëm financiar

ANEKSI I
RREGULLAT QË RREGULLOJNË KONTRIBUTIN FINANCIAR TË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E TREGUT TË PËRBASHKËT (2021–2027)

I. Llogaritja e kontributit financiar të Shqipërisë

1. Kontributi financiar i Shqipërisë në Programin e Tregut të Përbashkët përcaktohet në bazë vjetore në përpjesëtim me, dhe përveç shumës së disponueshme çdo vit në buxhetin e Unionit për ndarjet buxhetore të nevojshme për menaxhimin, ekzekutimin dhe funksionimin e Programit të Tregut të Përbashkët.

2. Tarifa e pjesëmarrjes, e përmendur në nenin 3(7) të kësaj Marrëveshjeje, do të ndahet si më poshtë:

- 2021: 0,5%;
- 2022: 1%;
- 2023: 1,5%;
- 2024: 2%;
- 2025: 2,5%;
- 2026: 3%;
- 2027: 4%.

3. Në përputhje me paragrafin 5, të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje, kontributi fillestar operacional që do të paguhet nga Shqipëria për pjesëmarrjen e saj në Programin e Tregut të Përbashkët do të llogaritet për vitet financiare përkatëse duke përdorur një rregullim në çelësin e kontributit.

Rregullimi i çelësit të kontributit do të jetë:

Çelësi i kontributit i rregulluar = Çelësi i kontributit x *Koeficientin*

Koeficienti i përdorur për llogaritjen e mësipërme për të rregulluar çelësin e kontributit do të jetë 0,01 për vitin 2021 dhe 0,50 për periudhën 2022–2027.

II. Pagesa e kontributit financiar të Shqipërisë

1. Komisioni do t'i komunikojë Shqipërisë, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se kur nxjerr thirrjen e parë për fonde të vitit financiar, informacionin e mëposhtëm:

a) shumat në ndarjet e angazhimeve në buxhetin e Unionit, të miratuara përfundimisht për vitin në fjalë për linjat buxhetore që mbulojnë pjesëmarrjen e Shqipërisë në Programin e Tregut të Vetëm;

b) shumën e tarifës së pjesëmarrjes, të përmendur në paragrafin 7 të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Në bazë të projektbuxhetit të tij, Komisioni do të ofrojë një vlerësim të informacionit për vitin pasardhës sipas pikave "a" dhe "b" sa më shpejt të jetë e mundur, dhe jo më vonë se deri më 1 shtator të vitit financiar.

2. Komisioni do të shpallë, jo më vonë se muaji prill i çdo viti financiar, një thirrje për fonde për Shqipërinë që korrespondon me kontributin e saj sipas kësaj Marrëveshjeje.

Thirrja për fonde do të parashikojë pagesën e kontributit të Shqipërisë jo më vonë se 30 ditë pas shpalljes së thirrjes për fonde.

Për tre vjetët e parë të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni do të shpallë një thirrje të vetme për fonde, brenda 60 ditëve nga data në të cilën kjo Marrëveshje fillon të japë efekte ligjore.

3. Shqipëria do të paguajë kontributin e saj financiar sipas kësaj Marrëveshjeje në përputhje me pikën II të këtij aneksi. Nëse Shqipëria nuk e kryen pagesën deri në datën e kërkueshme, Komisioni do të dërgojë një letër zyrtare kujtese.

Çdo vonesë në pagesën e kontributit financiar do të përbëjë shkak që Shqipëria të paguajë kamatë-vonesë për shumën e papaguar nga data e kërkueshme.

Norma e interesit për shumat e arkëtueshme të papaguara në datën e kërkueshme do të jetë norma e përdorur nga Banka Qendrore Evropiane për operacionet e saj kryesore të rifinancimit, siç është publikuar në serinë C të Gazetës Zyrtare të Bashkimit Evropian, në fuqi në ditën e parë kalendarike të muajit në të cilin bie afati i pagesës, e rritur me tre e gjysmë pikë përqindjeje.

ANEKSI II
MENAXHIMI I QËNDRUESHËM FINANCIAR
MBROJTJA E INTERESAVE FINANCIARE DHE RIKUPERIMI

Neni 1
Rishikimet dhe auditimet

1. Bashkimi Evropian ka të drejtë të kryejë, në përputhje me aktet e zbatueshme të një ose më shumë institucioneve ose organeve të Unionit dhe siç parashikohet në marrëveshjet dhe/ose kontratat përkatëse, rishikime dhe auditime teknike, shkencore, financiare ose të llojeve të tjera, në ambientet e çdo personi fizik me banim ose çdo subjekti juridik të themeluar në Shqipëri dhe që merr fonde nga Bashkimi Evropian, si dhe çdo pale të tretë të përfshirë në zbatimin e fondeve të Unionit me banim ose i themeluar në Shqipëri. Këto rishikime dhe auditime mund të kryhen nga agjentët e institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian, në veçanti, të Komisionit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve, ose nga persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni Evropian.

2. Agjentët e institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian, në veçanti të Komisionit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve, dhe personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni Evropian, do të kenë aksesin e duhur në vendet, punimet dhe dokumentet (si në versionet elektronike dhe në letër) dhe në të gjithë informacionin e kërkuar për të kryer auditime të tilla, duke përfshirë të drejtën për të marrë një kopje fizike/elektronike të, dhe ekstrakte nga çdo dokument ose përmbajtjet e çdo mjeti të të dhënave të mbajtur nga personi i audituar fizik ose juridik, ose nga pala e tretë e audituar.

3. Shqipëria nuk do të pengojë ose shkaktojë ndonjë pengesë të veçantë lidhur me të drejtën për të hyrë në Shqipëri dhe aksesin në ambientet e agjentëve dhe personave të tjerë të përmendur në paragrafin 2, për arsye të ushtrimit të detyrave të tyre të përmendura në këtë nen.

4. Rishikimet dhe auditimet mund të kryhen, gjithashtu, pas pezullimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje në bazë të paragrafit 5, të nenit 5 të saj, ndërprerjes së zbatimit të përkohshëm ose përfundimit të saj, në kushtet e përcaktuara në aktet e zbatueshme të një ose më shumë institucioneve ose organeve të Bashkimit Evropian dhe siç parashikohet në marrëveshjet dhe/ose kontratat përkatëse në lidhje me çdo angazhim ligjor që zbaton buxhetin e Bashkimit Evropian të lidhur nga Bashkimi Evropian përpara datës në të cilën pezullimi i zbatimit të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me paragrafin 5, të nenit 5 të saj, ndërprerja e zbatimit të përkohshëm ose përfundimi i kësaj Marrëveshjeje hyn në fuqi.

Neni 2
Lufta kundër parregullsive, mashtrimeve dhe veprave të tjera penale që prekin interesat financiare të Unionit

1. Komisioni Evropian dhe Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) autorizohen të kryejnë hetime administrative, duke përfshirë kontrolle dhe inspektime në vend, në territorin e Shqipërisë. Këto hetime kryhen në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara nga aktet në fuqi të një ose më shumë institucioneve të Unionit.

2. Autoritetet kompetente shqiptare do të informojnë Komisionin Evropian ose OLAF-in brenda një kohe të arsyeshme për çdo fakt ose dyshim për të cilin kanë marrë dijeni në lidhje me një parregullsi, mashtrim ose aktivitet tjetër të paligjshëm që prek interesat financiare të Unionit.

3. Kontrollet dhe inspektimet në vend mund të kryhen në ambientet e çdo personi fizik me banim ose person juridik të themeluar në Shqipëri dhe që merr fonde të Unionit, si dhe të çdo pale të tretë të përfshirë në zbatimin e fondeve të Unionit me banim ose e themeluar në Shqipëri.

4. Kontrollet dhe inspektimet në vend përgatiten dhe kryhen nga Komisioni Evropian ose OLAF-i, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetin kompetent shqiptar të caktuar nga qeveria shqiptare. Autoritetit të caktuar do t'i njoftohet paraprakisht një afat i arsyeshëm për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe inspektimeve, në mënyrë që të mund të ofrojë asistencë. Për këtë qëllim, zyrtarët e autoriteteve kompetente shqiptare mund të marrin pjesë në kontrollet dhe inspektimet në vend.

5. Me kërkesë të autoriteteve shqiptare, kontrollet dhe inspektimet në vend mund të kryhen së bashku me Komisionin Evropian ose OLAF-in.

6. Agjentët e Komisionit dhe stafi i OLAF-it do të kenë akses në të gjithë informacionin dhe dokumentacionin, përfshirë të dhënat kompjuterike mbi operacionet në fjalë, që kërkohen për kryerjen e duhur të kontrolleve dhe inspektimeve në vend. Ata mund, në veçanti, të kopjojnë dokumentet përkatëse.

7. Kur personi, subjekti ose një palë tjetër e tretë i reziston një kontrolli ose inspektimi në vend, autoritetet shqiptare, duke vepruar në përputhje me rregullat dhe rregulloret kombëtare, do të ndihmojnë Komisionin Evropian ose OLAF-in për t'i lejuar ata të përmbushin detyrën e tyre për kryerjen e një kontrolli ose inspektimi në vend. Kjo asistencë do të përfshijë marrjen e masave të duhura paraprake sipas ligjit kombëtar, veçanërisht për të mbrojtur provat.

8. Komisioni Evropian ose OLAF-i do të informojnë autoritetet shqiptare për rezultatin e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve. Në veçanti, Komisioni Evropian ose OLAF-i do t'i raportojnë sa më shpejt të jetë e mundur autoritetit kompetent shqiptar çdo fakt ose dyshim në lidhje me një parregullsi për të cilën kanë marrë dijeni gjatë kontrollit ose inspektimit në vend.

9. Pa cenuar zbatimin e ligjit penal shqiptar, Komisioni Evropian mund të vendosë masa administrative dhe penalitete ndaj personave juridikë ose fizikë të Shqipërisë që marrin pjesë në zbatimin e një programi ose aktiviteti në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

10. Për qëllime të zbatimit të duhur të këtij neni, Komisioni Evropian ose OLAF-i dhe autoritetet kompetente shqiptare do të shkëmbejnë rregullisht informacion dhe, me kërkesë të njërës prej palëve në këtë Marrëveshje, do të konsultohen me njëra-tjetrën.

11. Për të lehtësuar bashkëpunimin efektiv dhe shkëmbimin e informacionit me OLAF-in, Shqipëria do të caktojë një pikë kontakti.

12. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet Komisionit Evropian ose OLAF-it dhe autoriteteve kompetente shqiptare do të bëhet duke respektuar kërkesat e konfidencialitetit. Të dhënat personale të përfshira në shkëmbimin e informacionit do të mbrohen në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

13. Autoritetet shqiptare do të bashkëpunojnë me Prokurorinë Publike Evropiane për t'i mundësuar përmbushjen e detyrës së saj për të hetuar, ndjekur penalisht dhe sjellë para gjykimit autorët dhe bashkëpunëtorët e veprave penale që prekin interesat financiare të Bashkimit Evropian në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3
Rikuperimi dhe zbatimi

1. Vendimet e miratuara nga Komisioni Evropian që vendosin një detyrim monetar ndaj personave juridikë ose fizikë përveç Shteteve, në lidhje me çdo pretendim që rrjedh nga Programi i

Tregut të Përbashkët, do të jenë të zbatueshme në Shqipëri. Urdhri i ekzekutimit i bashkëngjitet vendimit, pa ndonjë formalitet tjetër përveç verifikimit të origjinalitetit të vendimit nga autoriteti kombëtar i caktuar për këtë qëllim nga qeveria e Shqipërisë. Qeveria e Shqipërisë do t'i bëjë të njohur Komisionit dhe Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian autoritetin e saj kombëtar të caktuar. Në përputhje me nenin 4, Komisioni Evropian ka të drejtë t'u njoftojë vendime të tilla të zbatueshme drejtpërdrejt personave me banim dhe subjekteve juridike të themeluara në Shqipëri. Zbatimi do të bëhet në përputhje me ligjin dhe rregullat e procedurës shqiptare.

2. Vendimet dhe urdhrat e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, të dhëna në zbatim të një klauzole arbitrazhi të përfshirë në një kontratë ose marrëveshje në lidhje me programet, aktivitetet, veprimet ose projektet e Unionit, do të jenë të zbatueshme në Shqipëri në të njëjtën mënyrë si vendimet e Komisionit Evropian të përmendura në paragrafin 1.

3. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ka juridiksion për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të përmendur në paragrafin 1 dhe për të pezulluar zbatimin e tij. Megjithatë, gjykatat e Shqipërisë do të kenë juridiksion mbi ankesat se zbatimi po kryhet në mënyrë të parregullt.

Neni 4
Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit

Institucionet dhe organet e Bashkimit Evropian, të përfshira në zbatimin e Programit të Tregut të Vetëm, ose në kontrollet mbi atë program, kanë të drejtë të komunikojnë drejtpërdrejt, përfshirë përmes sistemeve elektronike të shkëmbimit, me çdo person fizik me banim ose juridik të themeluar në Shqipëri dhe që merr fondet e Unionit, si dhe çdo palë të tretë e përfshirë në zbatimin e fondeve të Unionit, me banim ose e themeluar në Shqipëri. Këta persona, subjekte dhe palë mund t'u paraqesin drejtpërdrejt institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian të gjithë intonacionin dhe dokumentacionin përkatës që u kërkohet të dorëzojnë në bazë të legjislacionit të Bashkimit Evropian të zbatueshëm për programin e Unionit dhe të kontratave ose marrëveshjeve të lidhura për zbatimin e këtij programi.

INTERNATIONAL AGREEMENT

between the Republic of Albania, of the one part, and the European Union, of the other part, on the participation of the Republic of Albania in the Union programme Single Market Programme

The Government of the Republic of Albania (hereinafter referred to as Albania),

of the one part,

and

the European Commission (hereinafter referred to as 'the Commission'), on behalf of the European Union,

of the other part,

hereinafter referred to as 'the Parties'

WHEREAS a Framework Agreement has been signed on 22 November 2004 between the European Community and the Republic of Albania[1] which establishes the general principles for the participation of the Republic of Albania in Union programmes. Article 5 of the Framework Agreement provides that the specific terms and conditions, including financial contribution, with regard to the participation of Albania in each particular programme will be determined by the Commission and the Government of Albania;

WHEREAS the Union programme Single Market Programme was established by Regulation (EU) 2021/690 of the European Parliament and of the Council[2] (hereinafter referred to as "the Single Market Programme");

[1] OJ L 192, 22.7.2005, p. 2.

[2] Regulation (EU) 2021/690 of the European Parliament and of the Council of 28 April 2021 establishing a programme for the internal market, competitiveness of enterprises, including small and medium-sized enterprises, the area of plants, animals, food and feed, and European statistics (Single Market Programme) and repealing Regulations (EU) No 99/2013, (EU) No 1287/2013, (EU) No 254/2014 and (EU) No 652/2014, OJ L 153, 03.05.2021, p. 1.

WHEREAS the specific terms and conditions of the association should be determined by an international agreement between the Union and the associated country;

RECOGNISING the general principles as set out in Regulation (EU) 2021/690 of the European Parliament and of the Council;

WHEREAS, according to Regulation (EU) 2021/690 of the European Parliament and of the Council, acceding countries, candidate countries and potential candidates and European Neighbourhood Policy countries may participate in accordance with the general principles and general terms and conditions for the participation of those countries in Union programmes established in the respective framework agreements and Association Council decisions, or in similar agreements, and in accordance with the specific conditions laid down in agreements between the Union and those countries;

ACKNOWLEDGING the objectives of the Single Market Programme to improve the functioning of the internal market, and especially to protect and empower citizens, consumers and businesses, in particular SMEs, by enforcing Union law, facilitating market access, setting standards and promoting human, animal and plant health and animal welfare, whilst respecting the principles of sustainable development and ensuring a high level of consumer protection, as well as to develop, produce and disseminate high-quality, comparable, timely and reliable European statistics which underpin the design, monitoring and evaluation of all Union policies and help citizens, policymakers, authorities, businesses, academia and the media to make informed decisions and to actively participate in the democratic process;

RECOGNISING the common desire of the Parties to further develop, strengthen, stimulate and extend their relations and cooperation,

HAVE AGREED AS FOLLOWS:

Article 1

Scope of the association

Albania shall participate as associated country in and contribute to the specific objective corresponding to sub-paragraph 2(b), strengthening the competitiveness and sustainability of SMEs and achieving additionality at Union level, of the Single Market Programme as referred to in Article 3 of Regulation (EU) 2021/690 of the European Parliament and of the Council[3] in its most up to date version.

[3] Regulation (EU) 2021/690 of the European Parliament and of the Council of 28 April 2021 establishing a programme for the internal market, competitiveness of enterprises, including small and medium-sized enterprises, the area of plants, animals, food and feed, and European statistics (Single Market Programme) and repealing Regulations (EU) No 99/2013, (EU) No 1287/2013, (EU) No 254/2014 and (EU) No 652/2014, (OJ L 153, 03.05.2021, p. 1.)

Article 2

Terms and conditions of participation in the Single Market Programme

1. Albania shall participate in the Single Market Programme in accordance with the conditions laid down in the Framework Agreement between the European Community and the Republic of Albania on the General Principles for the participation of the Republic of Albania in Community Programmes, and under the terms and conditions set forth in this Agreement, in the legal act referred to in Article 1 of this Agreement, as well as in any other rules pertaining to the implementation of the Single Market Programme, in their most up to date versions.

2. Unless otherwise provided for in the terms and conditions referred to in paragraph 1 of this Article, legal entities established in Albania may participate in actions of the Single Market Programme under conditions equivalent to those applicable to legal entities established in the Union, including respect for EU restrictive measures[4].

3. Representatives of Albania shall have the right to participate as observers in the committees referred to in Article 21.1 of the Regulation (EU) 2021/690 of the European Parliament and of the Council, without voting rights and for points which concern Albania. The committee shall meet without the presence of the representatives of Albania the time of voting. Albania will be informed of the result.

4. Travel costs and subsistence expenses incurred by representatives and experts of Albania for the purposes of taking part as observers in the work of the committees referred to in Article 21.1 of the Regulation (EU) 2021/690 of the European Parliament and of the Council, or in other meetings related to the implementation of the Single Market Programme, shall be reimbursed by the European Union on the same basis as and in accordance with the procedures in force for representatives of the Member States of the European Union.

5. Albania shall take all necessary measures, as appropriate, to ensure that goods and services, purchased in Albania or imported into Albania, which are partially or entirely financed pursuant to the grant agreements and/or contracts concluded for the realisation of the activities in accordance with this Agreement, are exempted from customs duties, import duties and other fiscal charges, including the VAT, that are applicable in Albania.

[4] The EU restrictive measures are restrictive measures adopted pursuant to the Treaty on the European Union or the Treaty on the Functioning of the European Union.

Article 3

Financial contribution

1. Participation of Albania or Albania's legal entities in the Single Market Programme shall be subject to Albania contributing financially to the Programme and the related management, execution, and operation costs under the general budget of the Union (hereinafter referred to as the 'Union budget').

2. The financial contribution shall take the form of the sum of:
   a) an operational contribution; and
   b) a participation fee.

3. The financial contribution shall take the form of an annual payment made in one instalment and shall be due at the latest in May.

4. The operational contribution shall cover operational and support expenditure of the Programme and be additional both in commitment and payment appropriations to the amounts entered in the Union budget definitively adopted for the Single Market Programme.

5. The initial operational contribution shall be based on a contribution key defined as the ratio of the Gross Domestic Product (GDP) of Albania at market prices to the GDP of the Union at market prices. The GDPs at market prices to be applied shall be determined by the dedicated Commission services based on the most recent statistical data available for budget calculations in the year prior to the year in which the annual payment is due. Adjustments to this contribution key are laid down in Annex I.

6. The initial operational contribution shall be calculated applying the contribution key, as adjusted, to the initial commitment appropriations entered in the Union budget definitively adopted for the applicable year for financing the Single Market Programme.

7. The participation fee shall be 4% of the annual initial operational contribution as calculated in accordance with paragraphs 5 and 6 and shall be phased in as set out in Annex I. The participation fee shall not be subject to retrospective adjustments or corrections.

8. The Union shall provide Albania with information in relation to its financial participation as included in the budgetary, accounting, performance and evaluation related information provided to the Union budgetary and discharge authorities concerning the Single Market Programme. That information shall be provided having due regard to the European Union's and Albania's confidentiality and data protection rules and shall be without prejudice to the information which Albania is entitled to receive under Annex II.

9. All contributions of Albania or payments from the Union, and the calculation of amounts due or to be received shall be made in euro.

Article 4

Monitoring, Evaluation and Reporting

1. Without prejudice to the responsibilities of the Commission, the European Anti-Fraud Office (OLAF) and the Court of Auditors of the European Union in relation to monitoring and evaluation of the Single Market Programme, the participation of Albania in that Programme shall be continuously monitored on a partnership basis involving the Commission and Albania.

2. The rules concerning sound financial management, including the financial control, recovery and other antifraud measures in relation to Union funding under this Agreement are laid down in Annex II.

Article 5

Final provisions

1. This Agreement shall enter into force on the date on which the Parties have notified each other of the completion of their internal procedures necessary for that purpose.

2. This Agreement shall apply from 1 January 2021. It shall remain in force for as long as is necessary for all the projects and actions, activities or parts thereof financed from the Single Market Programme, all the actions necessary to protect the financial interests of the European Union and all the financial obligations stemming from the implementation of this Agreement between the Parties to be completed.

3. The European Union and Albania may apply this Agreement provisionally in accordance with their respective internal procedures and legislation. The provisional application shall begin on the date on which the Parties have notified each other of the completion of their internal procedures necessary for that purpose.

4. Should Albania notify the Commission acting on behalf of the Union that it will not complete its internal procedures necessary for the entry into force of this Agreement, this Agreement shall cease to apply provisionally on the date of receipt of this notification by the Commission, which shall constitute the cessation date for the purposes of this Agreement.

5. The application of this Agreement may be suspended by the European Union in case of non-payment of the financial or operational contribution due by Albania in accordance with point II of paragraph 3 of Annex I.

In case of non-payment which may significantly jeopardise the implementation and management of the Single Market Programme, the Commission shall send a formal letter of reminder. Where no payment is made within 20 working days after the formal letter of reminder, suspension of the application of this Agreement shall be notified by the Commission to Albania by a formal letter of notification which shall take effect 15 days

following the receipt of this notification by Albania.

Suspension of the application of this Agreement shall be notified by the European Union to Albania by a formal letter of notification which shall take effect 15 days following the receipt of this notification by Albania.

In case the application of this Agreement is suspended, legal entities established in Albania shall not be eligible to participate in award procedures not yet completed when the suspension takes effect. An award procedure shall be considered completed when legal commitments have been entered into as a result of that procedure.

The suspension does not affect the legal commitments entered into with the legal entities established in Albania before the suspension took effect. This Agreement shall continue to apply to such legal commitments.

The European Union shall immediately notify Albania once the entire amount of the financial or operational contribution due has been received by it. The suspension shall be lifted with an immediate effect upon this notification.

As of the date when the suspension is lifted, legal entities of Albania shall be again eligible in award procedures launched after this date and in award procedures launched before this date, for which the deadlines for submission of applications has not expired.

6. Either Party may terminate this Agreement at any time by a written notification informing of the intent to terminate it.

The termination shall take effect three calendar months after the date on which the written notification reaches its addressee. The date on which the termination takes effect shall constitute the termination date for the purposes of this Agreement.

7. Where this Agreement ceases to apply provisionally in accordance with paragraph (4) or is terminated in accordance with paragraph (6), the Parties agree that:

(a) projects or actions, activities or parts thereof in respect of which legal commitments have been entered into during the provisional application and/or after the entry into force of this Agreement, and before this Agreement ceases to apply or is terminated shall continue until their completions under the conditions laid down in this Agreement;

(b) the annual financial contribution of the year N during which this Agreement ceases to apply provisionally or is terminated shall be paid in accordance with Article 3.

The Parties shall settle by common consent any other consequences of termination or cessation of provisional application of this Agreement.

8. This Agreement may only be amended in writing by common consent of the Parties. The entry into force of the amendments will follow the same procedure as that applicable for the entry into force of this Agreement.

9. The Annexes to this Agreement shall form an integral part of this Agreement.

10. English shall be used for the procedures related to requests, contracts and reports, as well as for other administrative aspects of the Single Market Programme.

This Agreement shall be drawn up in duplicate in English and Albanian, each text being equally authentic. In case of divergence of interpretation, the English text shall prevail.

Done at Brussels, this 19th day of December in the year 2023.

For the Republic of Albania,

Endrit YZEIRAJ

Deputy Minister of Finance and Economy

For the Commission, on behalf of the European Union,

Kerstin JORNA

Director-General

Directorate-General for Internal Market, Industry, Entrepreneurship and SMEs

ANNEX I: Rules governing the financial contribution of Albania to the Single Market Programme (2021-2027)

ANNEX II: Sound Financial Management

Annex I

Rules governing the financial contribution of Albania to the Single Market Programme (2021-2027

I. Calculation of Albania's financial contribution

1. The financial contribution of Albania to the Single Market Programme shall be established on a yearly basis in proportion to, and in addition to, the amount available each year in the Union budget for commitment appropriations needed for the management, execution and operation of the Single Market Programme.

2. The participation fee referred to in Article 3(7) of this Agreement shall be phased in as follows:
   - 2021: 0,5%;
   - 2022: 1%;
   - 2023: 1,5%;
   - 2024: 2%;
   - 2025: 2,5%;
   - 2026: 3%;
   - 2027: 4%.

3. In accordance with Article 3(5) of this Agreement, the initial operational contribution to be paid by Albania for its participation in the Single Market Programme will be calculated for the respective financial years by applying an adjustment to the contribution key.

The adjustment to the contribution key shall be:

$$\text{Contribution Key Adjusted} = \text{Contribution Key} \times Coefficient$$

The coefficient used for the above calculation to adjust the contribution key shall be 0.01 for 2021 and 0.50 for 2022 - 2027.

II. Payment of Albania's financial contribution

1. The Commission shall communicate to Albania, as soon as possible and at the latest when issuing the first call for funds of the financial year, the following information:
   a. the amounts in commitment appropriations in the Union budget definitively adopted for the year in question for the budget lines covering participation of Albania, in Single Market Programme;
   b. the amount of the participation fee referred to in Article 3(7) of this Agreement;

On the basis of its Draft Budget, the Commission shall provide an estimate of information for the following year under points (a) and (b) as soon as possible, and, at the latest, by 1 September of the financial year.

2. The Commission shall issue, at the latest in April of each financial year, a call for funds to Albania corresponding to its contribution under this Agreement.

   The call for funds shall provide for the payment of Albania's contribution not later than 30 days after the call for funds is issued.

   For the first three years of implementation of this Agreement, the Commission shall issue a single call for funds, within 60 days following the date on which this Agreement starts producing legal effects.

3. Albania shall pay its financial contribution under this Agreement in accordance with point II of this Annex. In the absence of payment by Albania by the due date, the Commission shall send a formal letter of reminder.

   Any delay in the payment of the financial contribution shall give rise to the payment of default interest by Albania on the outstanding amount from the due date.

   The interest rate for amounts receivable not paid on the due date shall be the rate applied by the European Central Bank to its principal refinancing operations, as published in the C series of *the Official Journal of the European Union*, in force on the first calendar day of the month in which the due date falls, increased by three and a half percentage points.

Annex II

Sound Financial Management

Protection of financial interests and recovery

Article 1

Reviews and audits

1. The European Union shall have the right to conduct, in accordance with the applicable acts of one or more Union institutions or bodies and as provided in relevant agreements and/or contracts, technical, scientific, financial, or other types of reviews and audits on the premises of any natural person residing in or any legal entity established in Albania and receiving European Union funding, as well as any third party involved in the implementation of Union funds residing or established in Albania. Such review and audits may be carried out by the agents of the institutions and bodies of the European Union, in particular of the European Commission and the European Court of Auditors, or by other persons mandated by the European Commission.

2. The agents of the institutions and bodies of the European Union, in particular of the European Commission and the European Court of Auditors, and the other persons mandated by the European Commission, shall have appropriate access to sites, works and documents (both in electronic and paper versions) and to all the information required in order to carry out such audits, including the right of obtaining a physical/electronic copy of, and extracts from, any document or the contents of any data medium held by the audited natural or legal person , or by the audited third party.

3. Albania shall not prevent or raise any particular obstacle to the right of entrance in Albania and to the access to the premises of the agents and other persons referred to in paragraph 2 on the grounds of the exercise of their duties referred to in this Article.

4. The reviews and audits may be carried out, also after the suspension of application of this Agreement pursuant to its Article 5(5), the cessation of provisional application or its termination, on the terms laid down in the applicable acts of one or more European Union

institutions or bodies and as provided in relevant agreements and/or contracts in relation to any legal commitment implementing the European Union budget entered into by the European Union before the date on which the suspension of application of this Agreement pursuant to its Article 5(5), the cessation of provisional application or termination of this Agreement takes effect.

Article 2

Fight against irregularities, fraud and other criminal offences affecting the financial interests of the Union

1. The European Commission and the European Anti-Fraud Office (OLAF) shall be authorised to carry out administrative investigations, including on-the-spot checks and inspections, on the territory of Albania. These investigations shall be carried out in accordance with the terms and conditions established by applicable acts of one or more Union institutions.

2. The competent Albanian authorities shall inform the European Commission or OLAF within reasonable time of any fact or suspicion which has come to their notice relating to an irregularity, fraud or other illegal activity affecting the financial interests of the Union.

3. On-the-spot checks and inspections may be carried out on the premises of any natural person residing in or legal entity established in Albania and receiving Union funds, as well as of any third party involved in the implementation of Union funds residing or established in Albania.

4. On-the-spot checks and inspections shall be prepared and conducted by the European Commission or OLAF in close collaboration with the competent Albanian authority designated by the Albanian government. The designated authority shall be notified a reasonable time in advance of the object, purpose and legal basis of the checks and inspections, so that it can provide assistance. To that end, the officials of the competent Albanian authorities may participate in the on-the-spot checks and inspections.

5. Upon request by the Albanian authorities, the on-the-spot checks and inspections may be carried out jointly with the European Commission or OLAF.

6. Commission agents and OLAF staff shall have access to all the information and documentation, including computer data, on the operations concerned, which are required for the proper conduct of the on-the-spot checks and inspections. They may, in particular, copy relevant documents.

7. Where the person, entity or another third party resists an on-the-spot check or inspection, the Albanian authorities, acting in accordance with national rules and regulations, shall assist the European Commission or OLAF, to allow them to fulfil their duty in carrying out an on-the-spot check or inspection. This assistance shall include taking the appropriate precautionary measures under national law, in particular in order to safeguard evidence.

8. The European Commission or OLAF shall inform the Albanian authorities of the result of such checks and inspections. In particular, the European Commission or OLAF shall report as soon as possible to the competent Albanian authority any fact or suspicion relating to an irregularity which has come to their notice in the course of the on-the-spot check or inspection.

9. Without prejudice to application of Albanian criminal law, the European Commission may impose administrative measures and penalties on legal or natural persons of Albania participating in the implementation of a programme or activity in accordance with European Union legislation.

10. For the purposes of proper implementation of this Article, the European Commission or OLAF and Albanian competent authorities shall regularly exchange information and, at the request of one of the parties to this Agreement, consult each other.

11. In order to facilitate effective cooperation and exchange of information with OLAF, Albania shall designate a contact point.

12. Information exchanged between the European Commission or OLAF and Albanian competent authorities shall take place having due regard to the confidentiality requirements. Personal data included in the exchange of information shall be protected in accordance with applicable rules.

13. Albanian authorities shall cooperate with the European Public Prosecutor's Office to allow it to fulfil its duty to investigate, prosecute and bring to judgment the perpetrators of, and accomplices to, criminal offences affecting the financial interests of the European Union in accordance with the applicable legislation.

Article 3

Recovery and enforcement

1. Decisions adopted by the European Commission imposing a pecuniary obligation on legal or natural persons other than States in relation to any claims stemming from the Single Market Programme shall be enforceable in Albania. The order for enforcement shall be appended to the decision, without any other formality than a verification of the authenticity of the decision by the national authority designated for this purpose by the government of Albania. The government of Albania shall make known its designated national authority to the Commission and the Court of Justice of the European Union. In accordance with Article 4, the European Commission shall be entitled to notify such enforceable decisions directly to persons residing and legal entities established in Albania. Enforcement shall take place in accordance with Albanian law and rules of procedure.

2. Judgments and orders of the Court of Justice of the European Union delivered in application of an arbitration clause contained in a contract or agreement in relation to Union programmes, activities, actions or projects shall be enforceable in Albania in the same manner as European Commission decisions referred to in paragraph (1).

3. The Court of Justice of the European Union shall have jurisdiction to review the legality of the decision of the Commission referred to in paragraph 1 and to suspend its enforcement. However, the Courts of Albania shall have jurisdiction over complaints that enforcement is being carried out in an irregular manner.

Article 4

Communication and exchange of information

The European Union institutions and bodies involved in the implementation of Single Market Programme, or in controls over that programme, shall be entitled to communicate directly, including through electronic exchange systems, with any natural person residing in or legal entity established in Albania and receiving Union funds, as well as any third party involved in the implementation of Union funds residing or established in Albania. Such persons, entities and parties may submit directly to the European Union institutions and bodies all relevant information and documentation which they are required to submit on the basis of the European Union legislation applicable to the Union programme and of the contracts or agreements concluded to implement that programme.

DEKRET
Nr. 156, datë 22.4.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 35/2024, "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian 'Programi i tregut të përbashkët për periudhën 2021–2027'".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 249, datë 24.4.2024

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT, TË PRONËS ME EMËRTIM "AGJENCIA PETRELË", ME VENDNDODHJE NË PETRELË, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 413, DATË 11.7.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES (DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT)", TË NDRYSHUAR, SI DHE PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË SHTETIT, NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 2947, PJESË E PASURISË ME NR. 444/16

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Mbrojtjes te Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të pronës me emërtim "Agjencia Petrelë", me vendndodhje në Petrelë, Tiranë, zona kadastrale 2947, me numër pasurie 444/15, sipas planrilevimit në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ngritjen e një qendre social-kulturore, multifunksionale, rekreacioni dhe argëtimi, me emërtimin "Parku tematik kulturor "*Tirana Art Garden*"".

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit të pronës së paluajtshme të shtetit, ndodhur në zonën kadastrale 2947, pjesë e pasurisë me nr. 444/16, sipas planrilevimit në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ngritjen e një qendre social-kulturore, multifunksionale, rekreacioni dhe argëtimi, me emërtimin "Parku tematik kulturor "*Tirana Art Garden*"".

3. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 413, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit)", të ndryshuar.

4. Fondit Shqiptar të Zhvillimit i ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pronave të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, si dhe tjetërsimi i tyre.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
Prona (DPRMSH) "Agjencia Petrelë", Petrelë, Tiranë

PRONARI REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM, (Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit) DATË 12/04/2024 QËLLIMI: Transferim nga MM te FSHZH

VENDNDODHJA
Bashkia Tiranë
TE DHËNAT E PASURISË
Lloi i pasurisë

DVASHK Tiranë Nr.Pasurisë 444/15 Z.K 2947 Indeksi i Hartës K-34-100-(60-C)
Sip e pasurisë 27 000 m² Sip. e gjurmës së ndërtimit 3335 m² Nr. kateve Nr. pemeve

Nord = 4569150.57 East = 486880.76 KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH) Nord = 4569150.57 East = 487571.98



SHPJEGUESE:

Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.1 = 125m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.2 = 387.5m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.3 = 406.25m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.4 = 387.5m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.5 = 781.25m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.6 = 781.25m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.7 = 375m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.8 = 85m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.9 = 6.25m²
Sip. e përgj. e gjurmës së ndërtimit të objekteve = 3335m²
Sip. përgj. e pronës = 27 000m²
Kufiri sipas HTR dhe faktit

Nord = 4568517.91 East = 486880.7776 SH 1: 2500 Nord = 4568517.91 East = 487571.98

NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	NIPT /GJIU
1	Veri				K51726024H
2	Lindje				
3	Jug				
4	Perëndim				

REALIZOI PËR IGJIU
Specialist Ramiz Haxhiu

KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI MArch. Teuta **KANXHERI**

REALIZOI PËR ASHK
Specialisti
DVASHK
Nënshkrimi
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori
Nënshkrimi/ Vula

TEKNOLOGJIA E MATJEVE Ortofoto 2015-2016, azhornimit në terren.
PËRCAKTIMI I KUFIRIT Sipas dokumentacionit hartografik arkivor marë në DPRMSH Agjencia Rajonale Tiranë.

Shënime : Ky planrilevim u hartua në zbatim të shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit nr.527/5, datë 09.04.2024 bazuar në dokumentacionin hartografik b/lidhur shkresës, dhe dokumentacionit HTR dhe kartela e pasurisë e dërguar elektronikisht nga ASHK me datë 12/04/2024.

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË MM, (Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit)

MIRATOHET
DREJTORI I PËRGJITHSHËM I REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT
Robert **HYSENLLARI**

ANEKSI 2

PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTET **DATË:** **QËLLIMI:INVENTARIZIMI/REGJISTRIM**

VENDNDODHJA: PETRELE BASHKIA TIRANE DVASHK/ZVASHK TIRANE _____ ZONA KADASTRALE **2947** NR.PASURISË 444/16 INDEKS HARTE K-34-100-(60-C)

TË DHËNAT E PASURISË: LLOJI PASURISË -PA FRUT SIP. E PASURISË 37000m² SIP. E GJURMËS SË NDËRTIMIT =__ Nr.KATEVE ___ Nr.PEMËVE __

X=4569001.9,Y= 487255.3 **KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE** X=4568912.0, Y=487618.1



X=4568566.2, Y=487305.3 SHKALLA **1:2500** X=4568858.5, 487873.9

Nr	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHËNIME TË REALIZUESIT

REALIZOI PËR SUBJEKT PRIVAT

Emri: ***GEZIM SALJA***
Licensa Nr. ***T.0066/4*** *Date.* 14.05.2018
Kompania: ***"GSA GROUP"***
Data e Pergatitjes: **19**.*04.2024*
Nënshkrimi/vula

REALIZOI PËR ASHK

SPECIALISTI _____
DVASHK _____
NËNSHKRIMI _____

KONFIRMOI

PËRGJEGJËS/DREJTORI _____
NËNSHKRIMI / VULA

Gezim Salja — Digitally signed by Gezim Salja Date: 2024.04.19 14:03:15 +02'00'

TEKNOLOGJIA E MATJEVE _____Z_____
Kode për teknologjinë e matjeve: T - Terren; Z - Zyrë; O - Ortofoto; G - Gps; S - Stacion Total; D - Matje Distancash;

PËRCAKTIMI I KUFIRIT _____
Kode për përcaktimin e kufirit: P - Përfaqësues i Pronarëve; K - Kufitarët të gjithë; KP - Kufitarët Pjesërisht; PB - Përfaqësues Bashkie; HK - Harta Kadastrale:

SHËNIME TË VEÇANTA:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË

PRONARI/BASHKËPRONARËT - DEKLARIM MBI MARRËDHËNIEN ME KUFITARËT

EMRI GËZIM IAN
NËNSHKRIMI_____

Kode për teknologjinë e matjeve dhe përcaktimit e kufirit: T - Terren; Z - Zyrë; O - Ortofoto; G - Gps; S - Stacion Total; D - Matje Distancash; P - Përfaqësues i Pronarëve; K - Kufitarët të gjithë; KP - Kufitarët Pjesërisht; PB - Përfaqësues Bashkie; HK - Harta Kadastrale:

VENDIM
Nr. 250, datë 24.4.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 535, DATË 13.9.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'IMPIANTI I TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA HIMARË DHE LARGIMI I UJËRAVE TË TRAJTUARA NË DET PËR ITUN HIMARË'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendës-kryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 535, datë 13.9.2023, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i projektvendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura Himarë dhe largimi i ujërave të trajtuara në det për ITUN Himarë"".

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura Himarë dhe largimi i ujërave të trajtuara në det për ITUN Himarë".

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit "godinë", "truall" dhe "ndërtesë", me vlerë të përgjithshme shpronësimi, prej 9 047 987.3 (nëntë milionë e dyzet e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë tre) lekësh.

4. Në pikën 4, fjalët "... prej 783 000 (shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë) lekësh ..." zëvendësohen me "... prej 9 047 987.3 (nëntë milionë e dyzet e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë tre) lekësh ...".

5. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.".

6. Në pikën 8, fjalët "... për likuidimin e pronarit ..." zëvendësohen me "... për likuidimin e pronarëve ...".

7. Tabelës bashkëlidhur vendimit nr. 535, datë 13.9.2023, të Këshillit të Ministrave, i shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Himarë.

III. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Himarë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

TABELA E SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 535, DATË 13.9.2023, 'PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'IMPIANTI I TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA HIMARË DHE LARGIMI I UJËRAVE TË TRAJTUARA NË DET PËR ITUN HIMARË""

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)							Të dhënat për shpronësim										
											"Truall"			"Ndërtesë"			Ndërtesë social-ekonomike			Vlera totale (lekë)	Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	"Truall" (m^2)	"Ndërtesë" (m^2)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera (lekë)		
2	Shkëlqim	Qazim	Shytaj	Himarë	1952	1/1952	Truall + ndërtesë	255	255	85	255.0	4,350.00	1,109,250.00	85.0	58,000.00	4,930,000.00			2,225,737.30	8,264,987.30	Leje legalizimi nr. 213550, datë 22.5.2020. Sip. katit përdhe 85 m^2. Sqarim: Vlerësimi i ndërtesës social-ekonomike (struktura ndihmëse) është bërë me situacion punimesh sipas raportit të vlerësimit.
Vlera totale																				8,264,987.30	

VENDIM
Nr. 251, datë 24.4.2024

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM, PËR MARRËVESHJEN ISTISNA'A DHE MARRËVESHJEN E AGJENCISË ISTISNA'A, PËR NDËRTIMIN E SEGMENTIT QUKËS–QAFË PLLOÇË, SI PJESË E KORRIDORIT RRUGOR TIRANË–KORÇË, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 128/2013, DHE MARRËVESHJEN NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES ISTISNA'A DHE TË MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË AGJENCISË ISTISNA'A, PËR NDËRTIMIN E SEGMENTIT QUKËS–QAFË PLLOÇË, SI PJESË E KORRIDORIT RRUGOR TIRANË–KORÇË, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 73/2022

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23 të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, për marrëveshjen Istisna'a dhe marrëveshjen e agjencisë Istisna'a, për ndërtimin e segmentit Qukës–Qafë Plloçë, si pjesë e korridorit rrugor Tiranë–Korçë, ratifikuar me ligjin nr. 128/2013, dhe marrëveshjen ndryshuese të marrëveshjes Istisna'a dhe të marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së agjencisë Istisna'a, për ndërtimin e segmentit Qukës–Qafë Plloçë, si pjesë e korridorit rrugor Tiranë–Korçë, ratifikuar me ligjin nr. 73/2022, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE NDRYSHUESE[11]
DATË 13 SHKURT 2024
KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKA ISLAMIKE PËR ZHVILLIM

Tabela e përmbajtjes

1. Përkufizime dhe interpretime
2. Ndryshimet në marrëveshjen e financimit
3. Detyrime të vazhdueshme
4. Përfaqësimet dhe garancitë
5. Efektshmëria dhe hyrja në fuqi
6. Njoftimet
7. Kopjet
8. Të drejtat e palëve të treta
9. Marrëveshja e plotë
10. Ndryshimi, rregullimi dhe heqja
11. Ndashmëria
12. Delegimi
13. Garancitë e mëtejshme
14. Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni
Faqja e nënshkrimit në marrëveshjen ndryshuese

Kjo Marrëveshje Ndryshuese ("Marrëveshja") lidhet më datë _____2023 ("Data e nënshkrimit") ndërmjet:

1. Bankës Islamike për Zhvillim (Banka); dhe
2. Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Përfituesi)

Banka dhe Përfituesi, në vijim të referuar bashkërisht si "Palët" dhe veçmas si "Pala".

[11] Marrëveshja Istisna'a e datës 12 prill 2013 e lidhur ndërmjet Përfituesit dhe Bankës për Ndërtimin e Segmentit Qukës–Qafë Plloçë të Projektit të Korridorit Rrugor Tiranë–Korçë

[2] Marrëveshja Ndryshuese e Marrëveshjes Istisna'a, e datës 4 korrik 2022, e lidhur ndërmjet Marrësit dhe Bankës mbi financimin shtesë për ndërtimin e segmentit Qukës–Qafë Plloçë, të Projektit të Korridorit Rrugor Tiranë–Korçë (sipas shitjes me këste).

Duke pasur parasysh se:

1. Banka dhe Përfituesi kanë nënshkruar Marrëveshjen e Financimit (siç përcaktohet në klauzolën 1 më poshtë (*Përkufizime dhe interpretime*).

2. Palët dëshirojnë të regjistrojnë disa ndryshime në Marrëveshjen e Financimit mbi dhe sipas termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

3. Kjo Marrëveshje ndryshon dhe plotëson Marrëveshjen e Financimit siç parashikohet në vijim;

Tashmë, si rrjedhojë, palët bien dakord si më poshtë:

1. Përkufizime dhe interpretime

1.1 Në këtë Marrëveshje:

"Datë e hyrjes në fuqi" do të thotë data në të cilën njoftimi i përmendur në klauzolën 5.1 *(Efektshmëria dhe hyrja në fuqi)* dorëzohet nga Përfituesi tek Banka.

"Marrëveshja Istisna'a" do të thotë Marrëveshja Istisna'a e datës 12 prill 2013, e lidhur ndërmjet Përfituesit dhe Bankës, në lidhje me Ndërtimin e Segmentit Qukës–Qafë Plloçë të Projektit të Korridorit Rrugor Tiranë–Korçë, në shumën $125,000,000 dollarë amerikanë.

"Marrëveshje Financimi" do të thotë Marrëveshja Ndryshuese e Marrëveshjes së Istisna'a të datës 4 korrik 2022, e lidhur ndërmjet Përfituesit dhe Bankës mbi Financimin Shtesë për Ndërtimin e Segmentit Qukës–Qafë Plloçë të Projektit të Korridorit Rrugor Tiranë–Korçë (sipas shitjes me këste) në shumën $ 56,800,000 dollarë amerikanë.

1.2 Çdo referencë në këtë Marrëveshje për një klauzolë, nënklauzolë, paragraf ose skedul i referohet, përveç kur përcaktohet ndryshe, një klauzolë ose nënklauzolë ose paragrafi të kësaj Marrëveshjeje ose skedulit të saj.

1.3 Termat dhe shprehjet me germa kapitale të përdorur, por që nuk janë të përcaktuara këtu, kanë të njëjtin kuptim që u jepet atyre në Marrëveshjen e Financimit.

1.4 Çdo referencë në këtë Marrëveshje për ndonjë ligj ose rregullore (qoftë legjislacioni parësor ose rregullore, rregulla, udhëzime zyrtare, urdhra, kërkesa ose direktiva të tjera të bëra në përputhje me legjislacionin parësor) do të interpretohet si një referencë për atë ligj, rregullore, rregull, udhëzim zyrtar, urdhër, kërkesë ose direktivë, siç mund të jenë ndryshuar ose rimiratuar ose siç mund të ndryshohen ose rimiratohen herë pas here.

1.5 Titujt dhe nëntitujt janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në hartimin e kësaj Marrëveshjeje.

1.6 Çdo referencë në këtë Marrëveshjeje ose çdo marrëveshje apo dokument tjetër do të hartohet në referim të kësaj Marrëveshjeje ose, sipas rastit, një marrëveshjeje ose dokumenti tjetër të tillë, siç mund të jenë ndryshuar, rinovuar, plotësuar apo rimiratuar, ose siç mund të ndryshohen, rinovohen, plotësohen apo rimiratohen herë pas here.

1.7 Të gjitha referencat për datat dhe periudhat kohore në këtë Marrëveshje, do të interpretohen në përputhje me kalendarin gregorian.

1.8 Fjalët që tregojnë njëjësin duhet të përfshijnë shumësin dhe anasjelltas.

2. NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN E FINANCIMIT

2.1 Sipas klauzolës 5 *(Efektshmëria)* të kësaj Marrëveshjeje, me efekt nga data e hyrjes në fuqi, Palët bien dakord dhe pranojnë se Marrëveshja e Financimit do të ndryshohet, siç përcaktohet në këtë klauzolë 2 *(Ndryshimet në Marrëveshjen e Financimit).*

2.2 Marrëveshja e Financimit do të ndryshohet si më poshtë:

2.2.1 "Rregullimi i diferencës midis dy çmimeve" në nenin 1.2 (*Përkufizime*) hiqet në tërësi dhe zëvendësohet me sa vijon:

"**Rregullimi i diferencës midis dy çmimeve"** do të thotë 42.826 pikë bazë."

2.2.2 Përkufizimi "**Norma Referuese Alternative"** në nenin 1.2 *(Përkufizime)* hiqet në tërësi dhe zëvendësohet me sa vijon:

"**Normë Referuese Alternative"** do të thotë, në lidhje me Normën SOFR (Norma Ditore e Siguruar e Financimit):

a) një vendim në mirëbesim nga Banka (vendim i cili do të jetë përfundimtar në mungesë të gabimit të dukshëm) se të paktën 10 (dhjetë) financime dypalëshe korporative ose sindikale të ngjashme nga financierë ndërkombëtarë për debitorë të ngjashëm, të ekzekutuar ose ndryshuar në një periudhë të tillë, ekzekutohen për t'u ndryshuar (sipas kërkesës) për të përfshirë ose për të miratuar një normë të re standardi për të zëvendësuar Normën SOFR (Norma Ditore e Siguruar e Financimit); ose

b) një vendim në mirëbesim nga Banka (vendim i cili do të jetë përfundimtar në mungesë të gabimit të dukshëm), se:

i.

A. administratori i Normës SOFR ose mbikëqyrësi i tij njofton publikisht se një administrator i tillë nuk përmbush detyrimet financiare; ose

B. informacioni publikohet në çdo urdhër, dekret, njoftim, kërkesë apo depozitim, sido që të jetë përshkruar, të ose të depozituar pranë një gjykate, tribunali, autoriteti shkëmbimi, rregullatori ose organi të ngjashëm administrativ, rregullator ose gjyqësor që konfirmon në mënyrë të arsyeshme se Administratori i Normës SOFR nuk përmbush detyrimet financiare,

me kusht që, në çdo rast, në atë kohë, nuk ka administrator pasues që të vazhdojë të japë Normën SOFR;

ii. Administratori i Normës SOFR, ose mbikëqyrësi rregullator për Administratorin e Normës SOFR, Sistemi i Rezervës Federale Amerikane, një zyrtar i ngarkuar me rastet e mospërmbushjes së detyrimeve financiare me juridiksion mbi Administratorin për Normën SOFR, një autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me juridiksion mbi Administratorin për Normën SOFR ose një gjykatë ose subjekt me autoritet të ngjashëm për rastet e mospërmbushjes së detyrimeve financiare ose zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mbi Administratorin për Normën SOFR, njofton publikisht se Administratori i Normës SOFR ka pushuar ose do të pushojë së siguruari Normën SOFR përgjithmonë ose mbi bazë të pacaktuar dhe në atë kohë nuk ka asnjë administrator pasues që të vazhdojë të japë Normën SOFR;

iii. Mbikëqyrësi rregullator i Administratorit të Normës SOFR, Sistemi i Rezervës Federale Amerikane, një zyrtar i ngarkuar me rastet e mospërmbushjes së detyrimeve financiare me juridiksion mbi Administratorin për Normën SOFR, një autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me juridiksion mbi Administratorin për Normën SOFR ose një gjykatë ose subjekt me autoritet të ngjashëm për rastet e mospërmbushjes së detyrimeve financiare ose zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mbi Administratorin për Normën SOFR, njofton publikisht se Norma SOFR ka qenë ose do të ndërpritet përgjithmonë ose për një periudhë të pacaktuar dhe në atë kohë nuk ka asnjë Administrator pasues që të vazhdojë të japë Normën SOFR; ose

iv. Administratori i Normës SOFR ose Mbikëqyrësi i tij njofton se Norma SOFR mund të mos përdoret më ose nuk është më përfaqësues; ose

c) Banka ka marrë një vendim në mirëbesim (vendim i cili do të jetë përfundimtar në mungesë të gabimit të dukshëm), se Norma SOFR, ndryshe nuk është më e përshtatshme për qëllime të të qenit një normë standarde, në lidhje me financimin e dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje.

2.2.3 Përkufizimi "Kosto e Kapitalit" në nenin 1.2 *(Përkufizime)* hiqet në tërësi.

2.2.4 Përkufizimi "Norma Referuese Alternative" në nenin 1.2 *(Përkufizime)* hiqet në tërësi dhe zëvendësohet me sa vijon:

"Norma Referuese Alternative" do të thotë një normë e cila përzgjidhet nga Banka në diskrecionin e saj të vetëm dhe duke marrë parasysh çdo normë:

i. zyrtarisht të caktuar, të propozuar ose të rekomanduar nga Administratori i Normës SOFR; ose

ii. zyrtarisht të caktuar, të propozuar ose të rekomanduar nga ndonjë Organ Përkatës Emërues; ose

iii. përgjithësisht të pranuar në tregun ndërkombëtar të financimit për financimet dypalëshe korporative ose sindikale të ngjashme nga huadhënësit ndërkombëtarë për huamarrësit e vendosur në mënyrë të ngjashme si pasues të përshtatshëm të Normës SOFR, siç dëshmohet me anë të miratimit ose përfshirjes (qoftë me ekzekutim fillestar apo ndryshim) të një norme të tillë në të paktën 10 (dhjetë) financime të tilla; ose

iv. që shpreh si normë përqindjeje në vit koston për Bankën të zgjatjes së financimit në bazë të kësaj Marrëveshjeje nga çfarëdo burimi që ajo mund të përzgjedhë në mënyrë të arsyeshme.

2.2.5 Përkufizimi "LIBOR" në nenin 1.2 *(Përkufizime)* hiqet në tërësinë e tij.

2.2.6 Përkufizimi "Normë Efektive e Rritjes" në nenin 1.2 *(Përkufizime)* hiqet tërësisht.

2.2.7 Përkufizimi "Faqe Transmetimi" në nenin 1.2 *(Përkufizime)* hiqet tërësisht.

2.2.8 Përkufizimi "Periudhë e Përshtatshme" në nenin 1.2 *(Përkufizime)* hiqet tërësisht.

2.2.9 Përkufizimi "Normë 10-vjeçare Mesatare e Kundërkëmbimit" në nenin 1.2 *(Përkufizime)* hiqet tërësisht.

2.3.10 Përkufizimi "Faktor Ponderues për Disbursimin" në Nenin 1.2 *(Përkufizime)* hiqet tërësisht.

2.3.11 Përkufizimi "Ditë pune e Sigurimeve të Qeverisë Amerikane" në nenin 1.2 *(Përkufizime)* hiqet tërësisht.

2.2.12 Përkufizimi i "SIFMA – Industria e Sigurimeve dhe Shoqata e Tregjeve Financiare" në nenin 1.2 *(Përkufizime)* hiqet tërësisht.

2.2.13 Paragrafi (v) i përkufizimit "Norma e Shkëmbimit" në nenin 1.2 *(Përkufizime)* hiqet tërësisht dhe zëvendësohet me sa vijon:

"v. pjesa e lëvizshmërisë ka një pagesë kuponi të normës SOFR (Norma e Indeksuar Ditore e Interesit) me frekuencë gjysmëvjetore dhe bazë numërimi aktuale 360-ditore.".

2.2.14 Përkufizimet e mëposhtme do të shtohen saktësisht sipas rendit alfabetik në nenin 1.2 *(Përkufizime):*

"SOFR" do të thotë norma e financimit e siguruar për një ditë (SOFR) e administruar nga Banka e Rezervës Federale të Nju-Jorkut (apo çdo person tjetër që merr përsipër administrimin e asaj norme) dhe e publikuar (përpara çdo korrigjimi, rillogaritjeje ose ripublikimi nga Administratori) nga Banka e Rezervës Federale të Nju-Jorkut (apo çdo person tjetër që merr përsipër publikimin e asaj norme).

"Norma SOFR" do të thotë norma referuese e SOFR-së e administruar nga *CME Group Benchmark Administration Limited* (apo çdo person tjetër që merr përsipër administrimin e asaj norme) për një periudhë 6-mujore, e publikuar (para çdo korrigjimi, rillogaritjeje ose ripublikimi nga Administratori) nga *CME Group Benchmark Administration Limited* (apo çdo person tjetër që merr përsipër publikimin e asaj norme), me kusht që në rast se një normë e tillë është negative, norma SOFR *(Norma e Indeksuar Ditore e Interesit)* do të konsiderohet të jetë zero.

"Rregullimi i Diferencës midis Dy Çmimeve të Normës SOFR" do të thotë diferenca midis dy çmimeve ndërmjet Normës SOFR dhe Normës Referuese Alternative, e cila mund të jetë pozitive, negative ose zero dhe përcaktohet nga banka në diskrecionin e saj të vetëm, me qëllim ruajtjen e ekonomisë bazë të financimit të dhënë, sipas Dokumenteve të Financimit për Përfituesin dhe Bankën, duke marrë në konsideratë:

a) çdo përzgjedhje apo rekomandim për rregullimin e diferencës midis dy çmimeve apo çdo metodë për llogaritjen dhe përcaktimin e rregullimit të diferencës midis dy çmimeve për zëvendësimin e Normës SOFR në një moment të caktuar prej Shoqatës Ndërkombëtare të Shkëmbimeve dhe Derivateve, ose Entit Përkatës Caktues; ose

b) çdo marrëveshje tregu në zhvillim apo mbizotëruese në atë moment për llogaritjen dhe përcaktimin e rregullimit të diferencës midis dy çmimeve për zëvendësimin e Normës SOFR.

"**Norma e shkëmbimit të USD SOFR"** është norma e referimit për çmimin mesatar për pjesën e pandryshueshme të transaksionit së shkëmbimit të Dollarit Amerikan nga të pandryshueshme në të ndryshueshme, ku pjesa e ndryshueshme i referohet SOFR-së. Si pjesa e pandryshueshme ashtu edhe pjesa e ndryshueshme paguhen çdo vit, siç parashikohet nga *ICE Benchmark Administration* (apo një Administrator pasues).

2.2.15 Paragrafi 4.3 i nenit 4 *(Shitja e Aseteve të Projektit)* hiqet tërësisht dhe zëvendësohet me sa vijon:

4.3 "**Rënia e SOFR-së".** Pavarësisht ndonjë pike për të kundërtën në këtë Marrëveshje, në vijim të një vendimi në mirëbesim nga Banka (vendim që duhet të jetë përfundimtar dhe pa gabime të dukshme) që ka ndodhur një Rast Zëvendësimi i Normës së Referimit;

a) Banka, në diskrecionin e saj të vetëm, mund të propozojë ndryshime të kësaj Marrëveshjeje për të garantuar përdorimin e një Norme të Referencës së Zëvendësimit; dhe

i. të harmonizojë çdo dispozitë të kësaj Marrëveshjeje me përdorimin e Normës të Referencës së Zëvendësimit;

ii. të mundësojë që Norma e Referencës së Zëvendësimit të përdoret për llogaritjen e çdo norme apo dispozite të zbatueshme (duke përfshirë, pa kufizim, çdo ndryshim pasues që kërkohet për të mundësuar përdorimin e Normës së Referencës së Zëvendësimit për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje);

iii. të zbatojë marrëveshjet e tregut të zbatueshme për Normën e Referencës së Zëvendësimit;

iv. të marrë masa për rënien përkatëse (dhe çrregullimet e tregut) për atë Normë të Referencës së Zëvendësimit;

v. të rregullojë çmimet për të zvogëluar apo për të eliminuar, në masën e lejueshme në mënyrë të arsyeshme, çdo transferim të vlerës ekonomike nga njëra palë tek tjetra si rezultat i zbatimit të Normës së Referencës të Zëvendësimit me anë të Rregullimit

të Diferencës midis dy Çmimeve të Normës SOFR; dhe

vi. të sigurojë çdo ndryshim tjetër teknik, administrativ apo operacional të kësaj Marrëveshjeje që Banka e çmon të nevojshëm për të pasqyruar miratimin dhe zbatimin e një Norme të Referencës të Zëvendësimit dhe Rregullimit të Diferencës midis dy Çmimeve të Normës SOFR për të mundësuar administrimin nga ana e Bankës në një mënyrë kryesisht në përputhje me praktikat e tregut (ose, nëse Banka përcakton që miratimi i një pjese të caktuar të praktikave të tregut nuk është i mundur nga pikëpamja administrative ose nëse Banka përcakton që nuk ekzistojnë praktika tregu për administrimin e Normës Referuese Alternative, në një mënyrë tjetër administrimi që Banka përcakton që është e nevojshme në mënyrë të arsyeshme, në lidhje me administrimin e kësaj Marrëveshjeje (ndryshime të tilla teknike, administrative dhe operacionale, **Ndryshimet Konformuese të Pikës së Referimit)**;

b) Nëse Banka synon që në diskrecionin e saj të vetëm, të propozojë Ndryshimin e Pikës së Referimit për Zëvendësimin, ajo duhet të njoftojë Përfituesin mbi secilën nga pikat e mëposhtme në një ose më shumë njoftime (secili duhet të jetë **Njoftim i Zëvendësimit të Pikës së Referimit)** dhe duhet të përcaktojë:

i. që ka ndodhur një Rast i Zëvendësimit të Pikës së Referimit dhe të citojë paragrafin përkatës të vendimit;

ii. Normën e propozuar të Referencës së Zëvendësimit;

iii. Rregullimin e Diferencës midis dy Çmimeve të Normës SOFR);

iv. ndryshime të tjera të propozuara të kësaj Marrëveshjeje të cilat mund të përfshijnë çdo Ndryshim Konformues të Pikës së Referimit; dhe

v. datën/at kur duhet të hyjë në fuqi Ndryshimi i Pikës së Referimit për Zëvendësimin e kësaj Marrëveshjeje (që nuk duhet të jetë përpara fundit të Datës së Përgjigjes, siç përcaktohet më poshtë);

c) nëse Përfituesi:

i. bie dakord me shkrim (marrëveshje e cila është e parevokueshme) përpara Datës së Përgjigjes me ndryshimet e paraqitura në Njoftimin e Zëvendësimit të Pikës së Referimit (apo në çdo Njoftim të rishikuar të Zëvendësimit të Pikës së Referimit të dakordësuar ndërmjet Bankës dhe Përfituesit përpara Datës së Përgjigjes); dhe/ose

ii. nuk njofton Bankën shprehimisht me shkrim në përputhje me paragrafin (d), si më poshtë, përpara Datës së Përgjigjes që ai kundërshton në mirëbesim Normën e Referencës së Zëvendësimit dhe Rregullimit të Diferencës midis dy Çmimeve të Normës SOFR, të përcaktuara nga ai moment, dhe që ka bindjen me mirëbesim se nuk është Rasti për Ndryshimin e Pikës së Referimit,

atëherë kjo Marrëveshje duhet të ndryshohet në përputhje me termat e Njoftimit të Zëvendësimit të Pikës së Referimit, duke përfshirë Ndryshimet Konformuese të Pikës së Referimit dhe këto ndryshime do të jenë përfundimtare dhe detyruese për Përfituesin dhe do të hyjnë në fuqi në datat përkatëse të specifikuara në Njoftimin e Zëvendësimit të Pikës së Referimit (ose duke iu referuar paragrafit (c) (i) si më lart, në datën kur Përfituesi ka paraqitur pëlqimin me shkrim për ndryshimet e paraqitura në Njoftimin e Zëvendësimit të Pikës së Referimit) pa firmë, veprim apo leje të mëtejshme të Përfituesit (pavarësisht ndonjë kërkese tjetër të përfshirë në këtë dokument);

d) Nëse Përfituesi njofton Bankën brenda 10 Ditësh Pune nga data e Njoftimit të Zëvendësimit të Pikës së Referimit **(Data e Përgjigjes)** që ai kundërshton në mirëbesim Normën e Referencës së Zëvendësimit dhe Rregullimit të Diferencës midis dy Çmimeve të Normës SOFR të paraqitura në njoftim ose që ka bindjen me mirëbesim që nuk është Rasti për Ndryshimin e Pikës së Referimit, Përfituesi gëzon të drejtën t'i kërkojë Bankës me shkrim një shlyerje të hershme të financimit të dhënë në vijim të kësaj Marrëveshjeje **(Kërkesë për Shlyerje të Hershme)**. Brenda 10 ditësh pune nga marrja e kërkesës për shlyerje të hershme prej Bankës, ajo (Banka) duhet t'i dërgojë Përfituesit një njoftim me shkrim ku duhet të përcaktojë;

i. datën kur duhet të hyjë në fuqi shlyerja e hershme, e cila duhet të përcaktohet prej Bankës në diskrecionin e saj të vetëm **(Data e Shlyerjes së Hershme)**;

ii. shumën që Përfituesi duhet t'i paguajë Bankës në Datën e Shlyerjes së Hershme, e cila duhet të jetë shuma e çdo Disbursimi që Banka i ka dërguar Përfituesit deri në Datën e Shlyerjes së Hershme plus çdo shtesë-rritje të Paradhënies së papaguar për çdo Disbursim deri në datën e Shlyerjes së Hershme (të llogaritur në përputhje me nenin 4.3) **(Shuma e Shlyerjes së Hershme)**; dhe

iii. dhe më pas, Përfituesit i kërkohet të paguajë shumën e plotë të Shlyerjes së Hershme në Datën e Shlyerjes së Hershme dhe shlyerjen përfundimtare të financimit të dhënë në vijim të Dokumenteve të Financimit. Për shmangien e çdo dyshimi, nëse Përfituesi nuk e njofton Bankën në datën e përgjigjes, siç specifikohet në nënseksionin (d), atëherë do të zbatohet Norma e Referencës së Zëvendësimit dhe Rregullimi i Diferencës midis dy Çmimeve të Normës SOFR në këtë Marrëveshje, sipas datës së përcaktuar në Njoftimin e Zëvendësimit të Normës së Referimit;

e) në bazë të dispozitave pararendëse, në lidhje me zbatimin e Normës së Referencës së Zëvendësimit dhe Rregullimit të Diferencës midis dy Çmimeve të Normës SOFR, pas miratimit të tyre nëpërmjet një Ndryshimi të Pikës së Referimit të Zëvendësimit, Banka ka të drejtë, në diksrecionin e saj të vetëm, të bëjë Ndryshimet Konformuese të Pikës së Referimit herë pas here dhe, pavarësisht çdo deklarimi të kundërt në këtë dokument, çdo ndryshim në zbatim të këtyre Ndryshimeve Konformuese të Pikës së Referimit do të hyjë në fuqi pas dorëzimit të një ndryshimi ku përfshihen këto Ndryshime Konformuese të Pikës së Referimit pa firmë, veprim apo leje të mëtejshme të Përfituesit (pavarësisht ndonjë kërkese tjetër të përfshirë në këtë dokument); dhe

f) Banka nuk do të jetë përgjegjëse ose nuk do të ketë detyrim për ndonjë ushtrim të diksrecionit të saj apo për marrjen e vendimeve apo përcaktimeve të tjera, në lidhje me çështje që mbulohen nga neni 4.3, duke përfshirë, por pa u kufizuar, nëse ka ndodhur ose jo një Rast i Zëvendësimit të Pikës së Referimit, zbatimi apo moszbatimi i ndonjë Ndryshimi Konformues të Pikës së Referimit apo ndryshimeve të ngjashme në këtë Marrëveshje, dorëzimi apo mosdorëzimi të Njoftimit për Ndryshimin e Pikës së Referimit dhe/ose përcaktimi apo mospërcaktimi i ndonjë Norme Referuese Alternative dhe Rregullimit të Diferencës midis dy Çmimeve të Normës SOFR. Çdo përcaktim, vendim apo zgjedhje që Banka mund të bëjë sipas nenit 4.3, duke përfshirë çdo përcaktim/vendim, në lidhje me përmbajtjen, normën apo rregullimin apo të ndodhisë ose mosndodhisë së një rasti, rrethane ose date dhe çdo vendim për marrjen ose mosmarrjen e një veprimi do të jetë përfundimtar dhe detyrues, përveç gabimeve të dukshme dhe mund të kryhet në diksrecionin e vetëm të Bankës dhe pa pëlqimin e Përfituesit, përveç rasteve kur kërkohet shprehimisht në bazë të nenit 4.3.

2.2.16 Paragrafi 4.2 *(Parapagimi)* i nenit 4 *(Shitja e aseteve të projektit)* hiqet në tërësi dhe zëvendësohet me sa vijon:

"4.2 **Paradhënie:** Në përputhje me nenin 4.3 të Kushteve të Përgjithshme të Shitjes, Banka merr një paradhënie nga Përfituesi në përputhje me një njoftim për kryerjen e pagesës ("Njoftimi i pagesës") që Banka do t'i japë Përfituesit ("**Paradhënie**"). Një paradhënie e tillë llogaritet dhe paguhet si më poshtë:

a) Blerësi, në lidhje me çdo disbursim që i është dhënë gjatë periudhës së maturimit, do të kryejë një paradhënie ndaj Bankës në çdo datë pagese që bie në periudhën e maturimit. Çmimi i shitjes i pagueshëm nga Blerësi gjatë Periudhës së Pagesës, siç pasqyrohet në Skedulin e Pagesës, duhet të jetë neto i çdo Pagese të tillë Paraprake;

b) Paradhënia e pagueshme nga Blerësi në Bankë në lidhje me çdo Disbursim, do të jetë një shumë e barabartë me produktin e: i. normës në vit të barabartë me agregatin e Normës SOFR plus 155 Pikë Bazë në vit plus Rregullimin e Diferencës midis dy Çmimeve ("**Norma Individuale e rritjes");** dhe ii. shumën e Disbursimit përkatës, pjesëtuar me dy; dhe

c) Nëse një Paradhënie është e nevojshme të llogaritet në lidhje me një periudhë më pak sesa një periudhë e plotë e akumulimit të kthimit (siç përcaktohet më poshtë) **("Periudha Përkatëse**"), ajo do të llogaritet si një shumë e barabartë me produktin e: i. normës përkatëse individuale të rritjes; ii. shumës së Disbursimit përkatës; dhe iii. numrit të ditëve në një periudhë të tillë përkatëse të llogaritur në bazë të një viti prej 12 muajsh me 30 ditë pjesëtuar me 360 (ku rezultati rrumbullakoset deri në 0.01 dollarë amerikanë më të afërt, 0.005 dollarë amerikanë, duke u rrumbullakosur në rend ngjitës). Periudha nga dhe duke përfshirë Datën e Parë të Disbursimit, por duke përjashtuar Datën e Parë të Pagesës dhe çdo periudhë pasuese nga dhe duke përfshirë një Datë Pagese, por duke përjashtuar Datën tjetër pasuese të Pagesës, konsiderohet një "**Periudhë Akumulimi Kthimi**"."

2.2.17 Paragrafi 4.4 *(Çmimi i Shitjes)* i nenit 4 *(Shitja e Aseteve të Projektit)* hiqet në tërësinë e tij dhe zëvendësohet me sa vijon:

"4.4. **Çmimi i shitjes**: Çmimi i shitjes do të rillogaritet në fund të Periudhës së Maturimit bazuar në:

i. Disbursimet totale në fund të Periudhës së Maturimit, ose në momentin e shitjes; plus

ii. Një rritje të Normës së Shkëmbimit USD SOFR që mbizotëron në kohën që korrespondon me Periudhën e Pagesës plus 155 Pikë Bazë në vit plus Rregullimin e Diferencës midis dy Çmimeve.".

3. DETYRIME TË VAZHDUESHME

3.1 Me përjashtim të ndryshimeve në këtë Marrëveshje, dispozitat e Marrëveshjes së Financimit do të mbeten dhe do të vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë dhe do të përfshijnë kushtet e zbatueshme të kësaj Marrëveshjeje dhe do të lexohen dhe interpretohen si një dokument i plotë, me kushte të tilla të zbatueshme në këtë Marrëveshje.

3.2 Palët kanë lidhur një numër marrëveshjesh në lidhje me Marrëveshjen e Financimit. Për të shmangur dyshimet, Palët pranojnë se çdo dhe të gjitha marrëveshjet e lidhura do të mbeten dhe do të vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë dhe kur është e zbatueshme, do të përfshijnë kushtet e zbatueshme të kësaj Marrëveshjeje.

4. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

4.1 Përfituesi përfaqëson dhe garanton Bankën në datën e kësaj Marrëveshjeje se janë marrë ose kryer të gjitha autorizimet qeveritare dhe veprimet të çdo lloji, të nevojshme për të autorizuar ose që kërkohen për vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e detyrimeve të parashikuara në këtë Marrëveshjeje ndaj Përfituesit, dhe janë të vlefshme dhe në fuqi të plotë.

5. EFEKTSHMËRIA DHE HYRJA NË FUQI

5.1 Përfituesi merr përsipër të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, në mënyrë që të sigurojë që kjo Marrëveshje të jetë e vlefshme, detyruese dhe e zbatueshme në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe menjëherë pas përfundimit nga Përfituesi të të gjitha procedurave dhe kërkesave ligjore të brendshme të nevojshme për t'i dhënë fuqi kësaj Marrëveshjeje, Përfituesi i jep Bankës njoftim me shkrim, me kusht që ky njoftim të mund të dorëzohet jo më vonë se data që bie 60 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje (ose një datë e tillë e mëvonshme, siç mund të bihet dakord me shkrim ndërmjet palëve).

5.2 Palët në këtë mënyrë bien dakord që për qëllime të llogaritjes ose përcaktimit të çdo shume të pagueshme nga Përfituesi në Bankë pas Datës së Hyrjes në Fuqi, kjo shumë llogaritet sikur ndryshimet në Marrëveshjen e Financimit të përcaktuara në pikën 2 *(Ndryshimet në Marrëveshjen e Financimit)* efektshmëria do të jetë më 1 korrik 2023.

6. NJOFTIMET

6.1 Të gjitha njoftimet, kërkesat apo pëlqimet (**"Njoftimi"**) të parashikuara për ose të lejuara për t'u dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje, duhet të jenë me shkrim dhe duhet të jepen dorazi, me postë të vërtetuar ose të regjistruar (me shërbim korrieri me pagesë, të kërkohet dëftesë konfirmimi), me shërbim postar gjatë natës për dorëzim ditën e nesërme (dorëzim me parapagesë), ose me *email,* në adresat e dhëna për atë Palë, si më poshtë ose një adresë tjetër që ajo Palë mund të specifikojë me njoftimin me shkrim për Palën tjetër:

Për Përfituesin:

Marrësi: Ministria e Financave
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1
Tiranë, Republika e Shqipërisë
Telefon: +355 4 222 8405
Faks: +355 4 225 8494
Email: sekretariazv1@minfin.gov.al: sekretariamin@financa.gov.al

Për Bankën:

Marrës: Banka Islamike për Zhvillim
Adresa: 8111 King Khalid St. Al Nuzlah Al Yamania Dist. Njësia nr. 1, Jeddah-
22332-2444, Mbretëria e Arabisë Saudite
Telefon: +966 12 6361400
Faks: +966 12 6366871
E-mail: archives@isdb.org

6.2 Çdo Njoftim i bërë ose i dorëzuar nga njëra Palë tek Pala tjetër sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje, do të jetë në fuqi nëse dërgohet me letër ose *email* pas marrjes nga adresuesi.

6.3 Çdo njoftim që hyn në fuqi, në përputhje me pikën 6.2 sa më sipër, pas orës 17:00 në vendin e marrjes, do të konsiderohet se hyn në fuqi vetëm ditën e ardhshme.

6.4 Çdo Njoftim do të bëhet në gjuhën angleze.

7. KOPJET

7.1 Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet në të gjitha kopjet dhe nga Palët e saj, në kopje të veçanta por nuk do të jetë në fuqi derisa secila Palë të ketë nënshkruar të paktën një kopje. Çdo kopje e nënshkruar do të përbëjë një kopje origjinale të kësaj

Marrëveshjeje, por të gjitha kopjet së bashku do të përbëjnë një dhe të njëjtin instrument.

8. TË DREJTAT E PALËVE TË TRETA

8.1 Pavarësisht nga ndonjë kusht i Marrëveshjes së Financimit, pëlqimi i ndonjë personi që nuk është Palë, nuk mund të kërkojë në asnjë moment të anulojë apo ndryshojë këtë Marrëveshje.

9. MARRËVESHJA E PLOTË

9.1 Kjo Marrëveshje dhe të gjitha dokumentet e lidhura ose që do të lidhen në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, përbëjnë Marrëveshjen e plotë midis Palëve në lidhje me të gjitha çështjet e përmendura në këtë Marrëveshje.

10. NDRYSHIMI, KËRKESA PËR RREGULLIM DHE HEQJA DORË

10.1 Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshjeje nuk do jetë në fuqi nëse nuk bëhet me shkrim dhe nuk nënshkruhet nga ose në emër të të gjitha Palëve të kësaj Marrëveshjeje. Shprehja "rregullim" do të përfshijë, në çdo rast, çdo rregullim, plotësim, fshirje ose zëvendësim.

10.2 Çdo heqje dorë ose çdo e drejtë apo mospërmbushje e saj do të jetë efektive vetëm në rast kërkese dhe nuk do të ndikojë apo do të nënkuptojë heqje dorë nga ndonjë e drejtë tjetër ose e ngjashme apo mospërmbushje të ushtrimit në çdo rast pasues. Heqja dorë nga kjo Marrëveshje apo nga ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk do të jetë në fuqi nëse nuk është me shkrim dhe e nënshkruar nga Pala ndaj së cilës kërkohet të zbatohet heqja dorë.

10.3 Asnjë vonesë nga secila Palë në ushtrimin apo mosushtrimin e një të drejte apo mjeti ligjor sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk do të interpretohet si heqje dorë nga një e drejtë apo mjet ligjor ose heqje dorë nga të drejta apo mjete të tjera ligjore dhe asnjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i ndonjë të drejte apo mjeti ligjor, sipas kësaj Marrëveshjeje nuk pengon ushtrimin e mëtejshëm të ndonjë të drejte apo mjeti ligjor apo ushtrimin e ndonjë të drejte apo mjeti tjetër ligjor.

11. NDASHMËRIA

11.1 Çdo dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është e ndashme dhe e dallueshme nga të tjerat. Nëse në çdo kohë ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme në çfarëdo mase ose në çfarëdo rrethane për çfarëdo arsye, do të konsiderohet në atë masë ose në ato rrethana se nuk është pjesë e kësaj Marrëveshjeje, por (me përjashtim të asaj mase ose në ato rrethana në rastin e asaj dispozite), ligjshmëria, vlefshmëria dhe zbatueshmëria e saj dhe të gjitha dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje nuk do të cenohen në asnjë mënyrë.

12. DELEGIMI

12.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, kjo Marrëveshje dhe të drejtat dhe detyrimet e Palëve sipas saj, do të jenë të detyrueshme dhe të vlefshme në interesin e pasuesve, trashëgimtarëve, ekzekutuesve, administratorëve dhe përfaqësuesve ligjorë përkatës. Me përjashtim të pëlqimit paraprak me shkrim të Palës tjetër (që nuk do të mbahet, kushtëzohet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme), një Palë nuk do të transferojë, ose pretendojë të transferojë të gjithë ose ndonjë pjesë të përfitimit apo të drejtat apo përfitimet e saj sipas kësaj Marrëveshje (së bashku me çdo aktpadi që rrjedh në lidhje me të).

13. GARANCITË E MËTEJSHME

13.1 Secila Palë pranon të japë një informacion të tillë dhe të ndërmarrë veprime të tjera që mund të jenë të nevojshme ose që kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga Pala tjetër, të cilat nuk janë në kundërshtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe që nuk përfshijnë supozime të detyrimeve të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë Marrëveshje, për t'i dhënë fuqi të plotë Marrëveshjes dhe për të arritur qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

14. LIGJI DHE JURIDIKSIONI I ZBATUESHËM

14.1 Kjo Marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me parimet e Sheriatit Islam, siç janë shprehur nga Akademia Islame e Fikhut (Fiqh), Xhed (Jeddah), dhe shpallur në Standardet e Sheriatit të publikuara nga Organizata e Kontabilitetit dhe Auditimit për Institucionet Financiare Islame ("AAOIFI"), dhe siç interpretohen nga Bordi i Sheriatit të Bankës.

14.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve dhe çdo pretendim i një Palë drejtuar Palës tjetër që rrjedh nga kjo Marrëveshjeje, e cila/i cili nuk mund të zgjidhet me marrëveshje të palëve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i njërës palë drejtuar Palës tjetër, i paraqitet një paneli arbitrazhi për vendim përfundimtar dhe detyrues, në përputhje me rregullat dhe procedurat e Qendrës Ndërkombëtare Islamike për Pajtim dhe Arbitrazh (IICRA), Dubai, në Emiratet e Bashkuara Arabe. Rregullat dhe procedurat e arbitrazhit të IICRA-s do të zbatohen në mungesë të një procedure tjetër për përcaktimin

dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet Palëve të kësaj marrëveshjeje ose ndonjë pretendimi nga një Palë kundrejt palës tjetër.

14.3 Nëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas dhënies së kopjeve të vendimit Palëve, vendimi nuk zbatohet, secila Palë mund të kërkojë urdhër ekzekutimi ose të fillojë një procedurë për të ekzekutuar vendimin në çdo gjykatë me juridiksion kompetent ndaj Palës tjetër, mund të zbatojë këtë vendim me ekzekutim të detyruar ose mund të ndjekë ndonjë mjet tjetër të përshtatshëm kundër palës tjetër për zbatimin e vendimit ose dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

14.4 Çdo palë e kësaj Marrëveshjeje bie dakord që çdo vendim i dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje ndaj saj mund të ekzekutohet ndaj fondeve (aseteve) të saj në çdo juridiksion. Palët në këtë Marrëveshjeje heqin dorë në mënyrë të pakthyeshme nga çdo kundërshtim që mund të kenë për një padi, veprim apo gjykim që rrjedh nga ose në lidhje me ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse përcillet në një juridiksion në të cilin ato kanë fonde (asete) dhe nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje heq dorë në mënyrë të pakthyeshme nga çdo pretendim që një padi, veprim ose gjykim i tillë i paraqitur në një juridiksion të caktuar është ngritur në një mënyrë të papërshtatshme.

14.5 Në masën që Përfituesi në këtë Marrëveshje mund të pretendojë në një juridiksion për vete ose asetet e tij, imunitet nga padia, sekuestrimi, ekzekutimi (paraprak apo si ekzekutim para një vendimi arbitrazhi apo gjyqësor ose ndryshe) nga një proces gjyqësor tjetër ose në masën që në një juridiksion të tillë ky imunitet mund t'i atribuohet atij vetë ose aseteve të tij (qoftë i pretenduar apo jo), Përfituesi bie dakord në mënyrë të pakthyeshme të mos ketë pretendime dhe në këtë mënyrë heq dorë nga ky imunitet.

14.6 Dërgimi i çdo njoftimi ose procesi në lidhje me ndonjë procedurë sipas pikës 14.3 të kësaj Marrëveshjeje ose në lidhje me ndonjë procedurë për të zbatuar ndonjë vendim të dhënë në përputhje me pikën 14.3 të kësaj Marrëveshjeje, mund të bëhet në mënyrën e parashikuar në pikën 6 *(Njoftimet)* të kësaj Marrëveshje. Palët heqin dorë nga të gjitha kërkesat e tjera për dërgimin e çdo njoftimi ose procesi të tillë.

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e përcaktuar në fillim të kësaj Marrëveshjeje, nga përfaqësuesit e Palëve të autorizuar sipas rregullave.

FAQJA E NËNSHKRIMIT E MARRËVESHJES NDRYSHUESE

EKZEKUTUAR PËR DHE NË EMËR TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Nga:
Emri i plotë: **Ervin Mete**
Titulli: Ministër i Financave
22.1.2024

EKZEKUTUAR PËR DHE NË EMËR TË BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM
Nga:
Emri i plotë: **Dr. Muhammad Al Jasser**
Titulli: President, Islamic Development Bank

VENDIM
Nr. 252, datë 24.4.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 137, DATË 6.3.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURËS PËR DHËNIEN E PRONËS SHTETËRORE ME QIRA, ENFITEOZË, *LEASING*, SHITJE, PËRDORIM SI KOLATERAL DHE TË PËRDORIMIT NË FORMA TË TJERA NGA ANA E KORPORATËS SË INVESTIMEVE SHQIPTARE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, "Për Korporatën e Investimeve Shqiptare", me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, shkronja "ë" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"ë) në përfundim të zhvillimit të projektit, pas lidhjes së kontratave përkatëse të kalimit të pronësisë mbi objektin/objektet e ri/të reja, autorizimin e AIC-së për të kërkuar regjistrimin e sipërfaqeve shtetërore në pronësi të Republikës së Shqipërisë dhe në përgjegjësi administrimi ose në përdorim të partnerit publik, apo në pronësi të njësisë përkatëse

të vetëqeverisjes vendore ose të entit publik përkatës, në përputhje me kontratën. Pavarësisht nëse prona në gjendjen fillestare i është transferuar AIC-së në përdorim apo në pronësi, në çdo rast, në përfundim të zhvillimit të veprës, pjesa që i përket partnerit publik regjistrohet drejtpërdrejt në pronësi të Republikës së Shqipërisë dhe në përgjegjësi administrimi ose në përdorim të partnerit publik, apo në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore, ose të entit publik përkatës, sipas rastit.".

2. Ngarkohen e Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 253, datë 24.4.2024

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT TEK FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT, TË PRONËS ME SIPËRFAQE 9 600 m², ME NUMËR PASURIE 174/144, E NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 3266

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit, për realizimin e projektit "Mbështetje e infrastrukturës akomoduese për Polin e Ri të Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë Kibernetike", të pronës me sipërfaqe 9 600 (nëntë mijë e gjashtëqind) m², me numër pasurie 174/144, e ndodhur në zonën kadastrale 3266, sipas kartelës së pasurisë dhe fragmentit të hartës kadastrale, paraqitur në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Fondit Shqiptar të Zhvillimit i ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, si dhe tjetërsimi i pronës.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Shtojca nr. 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 3266025009
(Nga ____ , Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 3266 , Lloji i Pasurisë: TRUALL , Nr. i Pasurisë: 174/144 , Sipërfaqja Totale 9600 m2, (Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale - , Numri i Pemëve: 0 ,
Adresa e Pasurisë: Bashkia FARKE , Rruga - , Ndërtesa Nr. __ , SH/K __ , Apartamenti Nr. __
Vlera e Pasurisë:
Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 225 , Dt. 09/04/2024), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: REPUBLIKA E SHQIPËRISË , Nr. Identifikimi/NIPT R00000000SH, Pjesa Takuese 1/1,
Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia TIRANE , Rruga - , Ndërtesa Nr. __ , SH/K __ , Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Vendim i KM (për kalim në pronësi të institucionit shtetëror/apo vendimet e shpronësimit), Nr. 225 , Datë: 09/04/2024
Regjistruar: Nr. 16126 , Datë: 18/04/2024

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____ , me Kod Unik ____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT
16126	18/04/2024	Të drejta të tjera sipas legjislacionit në fuqi	VKM për të drejtën e administrimit/përdorimit	225	09/04/2024	99 vite	MINISTRIA ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË	J62119007M

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: ____ , Emërtimi i Aktit: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi: NE PERGJEGJESI ADMINISTRIMI TE MINISTRISE SE ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORI
Çelsea Terziu

Jetmir Lala — Digitally signed by: Jetmir Lala, Date: 2024.04.18 04:22:02 +02'00'
Persiana Bogdani — Digitally signed by: Persiana Bogdani, Date: 2024.04.18 05:05:10 +02'00'
Çelsea Terziu — Digitally signed by: Çelsea Terziu, Date: 2024.04.18 05:10:12 +02'00'

Data e lëshimit 18/04/2024

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1
Date:2024/04/18 16:21:38 +02'00'
J62119007M20240418162131 72ASHK

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

2/2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE:	**3266**	**KODI UNIK:**	**3266025009**
NUMRI PASURISË:	**174/144**	**INDEKSI HARTËS:**	**-**

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 2500

DREJTORI

Çelsea Terziu

Persiana Bogdani — Digitally signed by: Persiana Bogdani, Date: 2024.04.18 05:06:44 +02'00'

Data e lëshimit: 4/18/2024

celsea Terziu — Digitally signed by: celsea Terziu, Date: 2024.04.18 05:10:01 +02'00'

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1
Date:2024/04/18 17:05:46 +02'00'
R00000000SH20240418170539741401

SHPJEGUES

- PARCELA
- NDËRTESA

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

VENDIM
Nr. 254, datë 24.4.2024

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE, PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM (SDC) E DEPARTAMENTIT FEDERAL ZVICERAN TË PUNËVE TË JASHTME, DUKE VEPRUAR NËPËRMJET AMBASADËS SË ZVICRËS NË SHQIPËRI, NË MBËSHTETJE PËR GATISHMËRINË DHE REAGIMIN E SHËRBIMIT EMERGJENT SHËNDETËSOR, FAZA KRYESORE, NJË PROJEKT DYPALËSH BASHKËPUNIMI DHE ZHVILLIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme, duke vepruar nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, në mbështetje për gatishmërinë dhe reagimin e shërbimit emergjent shëndetësor, faza kryesore, një projekt dypalësh bashkëpunimi dhe zhvillimi, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE, PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM (SDC) E DEPARTAMENTIT FEDERAL ZVICERAN TË PUNËVE TË JASHTME, DUKE VEPRUAR NËPËRMJET AMBASADËS SË ZVICRËS NË SHQIPËRI, NË MBËSHTETJE PËR GATISHMËRINË DHE REAGIMIN E SHËRBIMIT EMERGJENT SHËNDETËSOR

Faza kryesore
Një projekt dypalësh bashkëpunimi dhe zhvillimi

Në përpjekje për të fuqizuar marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë midis dy vendeve;

në zbatim dhe aplikim të "Marrëveshjes kuadër për bashkëpunimin teknik, financiar dhe humanitar, ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Republikës së Shqipërisë", nënshkruar më 11 maj 2007 dhe ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 980l, më 13 shtator 2007;

në respektim të parimeve demokratike dhe të të drejtave themelore të njeriut - të përcaktuara në veçanti në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut - që frymëzojnë politikat e brendshme dhe të jashtme të të dyja palëve dhe përbëjnë një element thelbësor në baza të barabarta me objektivat e kësaj marrëveshjeje;

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Konfederatës Zvicerane

kanë rënë dakord për termat dhe kushtet e përcaktuara më poshtë:

Neni 1
Kushtet e përgjithshme dhe përkufizimet

Kudo që përdoren në këtë marrëveshje, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat vijues kanë kuptimet e mëposhtme:

a) "Palët kontraktuese" nënkupton Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverinë e Konfederatës Zvicerane;

b) "Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë" nënkupton qeverinë e Republikës së

Shqipërisë, të përfaqësuar nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

c) "Qeveria e Konfederatës Zvicerane" përfaqësohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme;

d) "Projekt" nënkupton mbështetje për gatishmërinë dhe reagimin e shërbimit emergjent shëndetësor;

e) "SDC" nënkupton Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim të Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme;

f) "Grant" nënkupton kontributin e dhënë nga qeveria e Konfederatës Zvicerane sipas kësaj marrëveshjeje;

g) "Partner zbatues" nënkupton partnerin zbatues të përzgjedhur nga qeveria e Konfederatës Zvicerane, sipas procedurave të tyre të brendshëm ligjore;

h) "SASPAC" nënkupton Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;

i) "Organet tatimore dhe doganore" nënkupton Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Neni 2
Autoritetet përgjegjëse

1. Përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes do të jenë autoritetet e mëposhtme:

a) Për qeverinë e Konfederatës Zvicerane:

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, e përfaqësuar nga Ambasada e Zvicrës në Shqipëri;

b) Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. SDC-ja, si autoriteti përgjegjës i palës zvicerane, do t'ia besojë zbatimin e projektit partnerit zbatues, të përzgjedhur nga qeveria e Konfederatës Zvicerane, sipas procedurave të tyre të brendshme ligjore.

Neni 3
Qëllime dhe objektiva

1. Kjo marrëveshje do të mbulojë fazën kryesore.

Objektivi kryesor i fazës kryesore është: Njerëzit, duke përfshirë më të prekshmit, kanë akses të përmirësuar në shërbimet cilësore të kujdesit emergjent, të menaxhuara nga një sistem më i qëndrueshëm i emergjencës shëndetësore në të gjitha nivelet.

2. Rezultatet kryesore të fazës kryesore përbëhen nga sa vijon:

- Aktorët e shëndetit publik angazhohen në një gatishmëri dhe reagim efektiv dhe efikas ndaj emergjencave shëndetësore;
- Shërbimet mjekësore emergjente të cilësisë së lartë janë në dispozicion për njerëzit në të gjithë vendin, veçanërisht në nivel të KSHP-së;
- Qytetarët dhe OSHC-të marrin një rol aktiv dhe kontribuojnë në një dialog konstruktiv me qeverinë shqiptare, për të përmirësuar qëndrueshmërinë e vendit ndaj emergjencave të shëndetit publik.

3. Për të arritur objektivin e kësaj marrëveshjeje, autoritetet përgjegjëse do të bashkëpunojnë me sektorin publik dhe privat, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, Institutin e Shëndetit Publik, Operatorin e Shërbimit Shëndetësor, Agjencinë e Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore dhe Shoqërore, Departamentin e Mjekësisë Interne nga Fakulteti i Mjekësisë, Fondin e Sigurimeve Shëndetësore (FSSH), bashkitë, organizatat lokale të shoqërisë civile, zyrën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë në Tiranë dhe grupet e interesit.

Neni 4
Detyrimet e palëve kontraktuese

1. Qeveria e Konfederatës Zvicerane, si palë kontraktuese, ka këto detyrime specifike:

a) deri në 31 tetor 2027, qeveria e Konfederatës Zvicerane do të angazhojë fonde, në formën e një granti të pakthyeshëm, ekuivalent me një shumë maksimale prej 4.764.000 franga zvicerane CHF (katër milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë), e cila do të përdoret ekskluzivisht për zbatimin e projektit sipas objektivave dhe rezultateve të përcaktuara në nenin 3;

b) ky grant nuk mund të shpërndahet për ndonjë qëllim tjetër. Çdo pjesë e pashfrytëzuar e grantit që mbetet në fund të projektit i nënshtrohet rimbursimit në qeverinë e Konfederatës Zvicerane;

c) granti do të disbursohet dhe auditohet sipas dispozitave të kontratës ndërmjet SDC-së dhe partnerit zbatues.

2. Detyrimet specifike të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfshijnë:

a) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale vepron si bashkëpërgjegjëse për strategjinë e projektit dhe si bashkëkryesuese në mbledhjet e Komitetit Drejtues;

b) Siguron lidhjen e projektit me politikat kombëtare dhe kuadrin ligjor përkatës për prioritetet e sektorit shëndetësor, për të mundësuar dhe promovuar koherencën e objektivave të projektit me kushtet në kuadrin kombëtar;

c) Mbështet lehtësimin dhe shpërndarjen e përvojave dhe informacionit, bazuar në rezultatet dhe ndikimet e arritura të projektit në nivel kombëtar;

d) Mbështet dhe lehtëson lidhjen dhe bashkë-punimin me ministritë dhe institucionet e tjera;

e) Siguron reagim dhe bashkëpunim të strukturave vartëse, në nivel rajonal dhe/ose lokal;

f) Mbështet dhe ndihmon në hartimin e aktiviteteve që do të përshkruhen në dokumentin e projektit;

g) Këshilli i Ministrave, bazuar në nenin 4, pika 1, shkronja "c", të "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran, për bashkëpunimin teknik, financiar dhe humanitar", ratifikuar me ligjin nr. 9801, datë 13.9.2007, u siguron, ekspertëve të huaj dhe familjeve të tyre, falas lejet e nevojshme të punës dhe qëndrimit, si dhe përjashtimet nga taksat, të gjitha detyrimet e tjera fiskale dhe detyrimet doganore, për importin e përkohshëm dhe rieksportin e sendeve personale;

h) Në zbatim të "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran, për bashkëpunimin teknik, financiar dhe humanitar", ratifikuar me ligjin nr. 980l, datë 13.9.2007, dhe ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar - fondet e përfituara për furnizimin e mallrave/shërbimeve nuk do të përdoren për të paguar taksat dhe mallrat e destinuara për realizimin e këtyre projekteve, përjashtohen nga TVSH-ja në import.

Neni 5
Menaxhimi i projektit

a) Projekti është një sipërmarrje e përbashkët ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Soci*ale* dhe SDC-së, nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës.

b) Qeveria e Konfederatës Zvicerane ka caktuar partnerin zbatues, të përzgjedhur nga qeveria e Konfederatës Zvicerane, sipas procedurave të tyre të brendshme ligjore, si partner zbatues për projektin. Partneri zbatues merr përsipër të gjitha detyrat operative dhe administrative të projektit, duke përfshirë buxhetin, disbursimet, monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve të projektit.

c) SDC-ja mund të caktojë gjithashtu ekspertë afatgjatë dhe afatshkurtër, të huaj dhe vendas, për të mbështetur zbatimin e projektit në konsultim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe bazuar në planin vjetor të aprovuar të operacioneve nga Komiteti Drejtues i projektit.

d) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e aktiviteteve të projektit, për të cilat është rënë dakord; bashkëlehtëson mbledhjet e Komitetit Drejtues; të sigurojë akses në informacionin përkatës, duke përfshirë të dhëna statistikore që konsiderohen të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të fazës fillestare. Informacioni do të përdoret vetëm për qëllimet e projektit.

e) Dokumentet strategjike të projektit duhet të miratohen nga Komiteti Drejtues përpara publikimit. Draftdokumentet duhet të ndahen me Komitetin Drejtues, të paktën 10 ditë përpara mbledhjeve të komitetit.

Neni 6
Mbikëqyrja dhe koordinimi

1. Për të siguruar mbikëqyrjen e përgjithshme, cilësinë, rëndësinë dhe bashkërendimin e projektit, si dhe për të adresuar çështjet e politikave, Komiteti Drejtues (KD) do të mblidhet dy herë në vit (maj dhe tetor).

2. Komiteti Drejtues (KD) do të përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë me të drejtë vendimi dhe 4 (katër) anëtarë me status vëzhgues dhe pa të drejtë vendimi, dhe do të bashkëkryesohet nga palët kontraktuese si më poshtë:

a) Anëtarët me të drejtë vendimi:

1 përfaqësues i Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri (bashkëkryetar);

1 përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (bashkëkryetar);

1 përfaqësues i Qendrës Kombëtare të Emergjencave Mjekësore;

1 përfaqësues i Agjencisë së Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor;

1 përfaqësues i Institutit të Shëndetit Publik;

1 përfaqësues i Operatorit të Shërbimit Shëndetësor;

1 përfaqësues i Fondit Kombëtar të Sigurimeve Shëndetësore;

1 përfaqësues i komunës;

l përfaqësues i organizatave të shoqërisë civile.

b) Anëtarët me statusin e vëzhguesit:

1 përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, administrata e spitalit;

1 përfaqësues i Departamentit të Mjekësisë Interne nga Fakulteti i Mjekësisë;

1 përfaqësues i OBSH-së;

1 përfaqësues i SASPAC.

Sipas nevojës dhe temës së diskutimit, aktorë të tjerë mund të ftohen të marrin pjesë nën rolin e vëzhguesit.

Sekretariati i Komitetit Drejtues sigurohet nga partneri zbatues. Drejtuesi i ekipit të projektit merr pjesë në takim pa të drejtë vendimi.

3. Komiteti Drejtues (KD) arrin kuorumin vetëm kur të gjithë përfaqësuesit me të drejtë vendimi janë të pranishëm. Vendimet merren me konsensus të të gjithë anëtarëve të pranishëm me të drejtë vendimi. Nëse nuk arrihet konsensus, do të fillojë një proces negocimi. SDC-ja, si përfaqësuese e qeverisë së Konfederatës Zvicerane, rezervon të drejtën e vendimit përfundimtar, në rast se nuk arrihet konsensusi pas procesit të negociatave.

Komiteti Drejtues do të kryejë këto detyra:

a) Shqyrton dhe diskuton progresin dhe prioritetet, në lidhje me sistemin e emergjencës shëndetësore në Shqipëri;

b) Shqyrton dhe miraton raportet gjashtëmujore dhe vjetore të progresit të projektit, duke përfshirë statusin e shpenzimeve kundrejt buxhetit;

c) Jep komente dhe miraton planin vjetor të aktiviteteve të projektit të paraqitura në SDC;

d) Monitoron progresin e zbatimit të projektit kundrejt objektivave/indikatorëve dhe planeve vjetore të punës;

e) Udhëzon aktivitetet hulumtuese dhe aktivitetet e monitorimit, dhe vlerësimit gjatë zbatimit të projektit;

f) Ofron udhëzime për projektin për përafrimin e aktiviteteve të tij vjetore, të detajuara në përputhje me prioritetet kombëtare;

g) Kërkon asistencë teknike të specializuar, të harmonizuar në fushat kyçe kur është e nevojshme;

h) Identifikon, diskuton dhe propozon zgjidhje për problemet e mundshme të sektorit të shëndetit publik në Shqipëri dhe masat e nevojshme;

Mbledhja e paplanifikuar mund të thirret me kërkesë të njërit prej anëtarëve të Komitetit Drejtues. Mbledhjet bashkëkryesohen nga palët kontraktuese.

Palët kontraktuese do të informojnë menjëherë njëra-tjetrën dhe, për aq sa është e mundur, do të konsultohen me njëra-tjetrën, në lidhje me çdo ngjarje, e cila ndërhyn ose kërcënon të ndërhyjë në zbatimin e suksesshëm të projektit.

Neni 7

Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve

a) Mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga të ardhurat e kontributit të Zvicrës do të prokurohet nga partneri zbatues, i përzgjedhur nga qeveria e Konfederatës Zvicerane sipas procedurave të tyre të brendshme ligjore, në përputhje me pragun e përcaktuar në zbatim të ligjit zviceran për prokurimin publik.

b) Gjatë kohëzgjatjes së projektit, mallrat e siguruara me fondet e SDC-së për përdorim në projekt do të mbeten në dispozicion të pakufizuar të projektit dhe nuk duhet të devijohen nga projekti pa miratimin paraprak me shkrim të SDC-së.

c) Nëse për ndonjë arsye projekti duhet të ndërpritet, përdorimi i mallrave të ofruara me kontributin zviceran do të vendoset me shkrim nga palët;

d) Në fund të projektit, SDC-ja do të vendosë për pronën dhe përdorimin e mallrave të prokuruara gjatë kohës së zbatimit të projektit.

e) Mallrat e prokuruara nga partneri zbatues për organizatat partnere do t'i dorëzohen dhe do të merren nga autoriteti kompetent përkatës me miratimin e SDC-së.

Neni 8
Pezullimi dhe përfundimi i marrëveshjes

a) Secila palë do të ketë të drejtën të përfundojë këtë marrëveshje, duke dhënë njoftim me shkrim për përfundimin e saj gjashtë muaj përpara.

b) Nëse njëra palë konsideron se qëllimet e kësaj marrëveshjeje nuk mund të arrihen më ose se pala e dytë nuk po përmbush detyrimet e saj, pala tjetër do të ketë të drejtë të pezullojë ose të përfundojë këtë marrëveshje, duke dhënë njoftim me shkrim tre muaj përpara. Pavarësisht nga sa më sipër, secila palë mund të përfundojë këtë marrëveshje, me efekt të menjëhershëm, në rast të shkeljes së konsiderueshme të marrëveshjes. Shkelje thelbësore nënkupton shkelje të rëndë të një prej objektivave thelbësorë të kësaj marrëveshjeje.

c) Pezullimi dhe hyrja e mundshme përsëri në fuqi do t'i njoftohet menjëherë palës tjetër me mjete diplomatike dhe do të hyjë në fuqi 30 ditë pas marrjes së informacionit nga pala tjetër.

d) Nëse ngjarjet që vijnë nga forca madhore (fatkeqësi natyrore, etj.) parandalojnë zbatimin e marrëveshjes, secila palë mund ta ndërpresë marrëveshjen, me efekt që nga momenti kur bëhet i pamundur zbatimi i saj.

e) Në rast të përfundimit të parakohshëm të kësaj marrëveshjeje ose në fund të projektit, çdo fond i pashpenzuar, i siguruar në kuadër të projektit, do t'i kthehet SDC-së.

Neni 9
Modifikimet dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo modifikim ose ndryshim i kësaj marrëveshjeje do të bëhet me shkrim, me pëlqimin e të dyja palëve. Mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen me negociata diplomatike ndërmjet palëve.

Neni 10
Dispozitat e përgjithshme

Brenda kuadrit të kësaj marrëveshjeje, palët nuk do të propozojnë as drejtpërdrejtë dhe as në mënyrë indirekte përfitime të çfarëdolloj natyre. Ato nuk do të pranojnë asnjë propozim të tillë. Çdo sjellje korruptive ose e paligjshme nënkupton shkelje të kësaj marrëveshjeje dhe justifikon përfundimin e saj, si dhe/ose rekursin ndaj masave korrigjuese plotësuese, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 11
Kohëzgjatja dhe efektiviteti

Kjo marrëveshje mbulon periudhën nga 1 nëntor 2023–31 tetor 2027. Ajo do të hyjë në fuqi me pas përfundimit të procedurave të brendshme ligjore.

Kjo marrëveshje është shkruar në dy kopje origjinale, në gjuhën angleze dhe shqipe. Të dyja versionet e teksteve janë autentike dhe kanë të njëjtën vlerë. Në rast të dallimeve të interpretimit do të mbizotërojë versioni anglisht.

Palët konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë marrëveshje të bërë në Tiranë, më datë

NË EMËR TË QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE	NË EMËR TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Ruth Huber	**Albana Koçiu**
Ambasador	**Ministër**
Ambasada e Zvicrës në Shqipëri	**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**

VENDIM
Nr. 255, datë 24.4.2024

PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2024

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për vitin 2024, procedura e plotësimit të pozicioneve të lira të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, për të cilat lëvizja paralele është mbyllur pa fitues, të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendet e lira.

2. Numri maksimal i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e përcaktuar në pikën 1, të

këtij vendimi, është 62 (gjashtëdhjetë e dy) pozicione të kategorisë së mesme dhe të ulët drejtuese.

3. Pozicionet, në të cilat mund të konkurrojnë edhe kandidatë nga jashtë shërbimit civil për nivelin e mesëm drejtues dhe për nivelin e ulët drejtues, përcaktohen në lidhjen nr .1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

POZICIONET NË TË CILAT MUND KONKURROJNË EDHE KANDIDATË NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL

I. Niveli i mesëm drejtues dhe të barasvlershëm

1. Jurist në Departamentin e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave, në Kryeministri;

2. Koordinator në Njësinë Kombëtare për Përafrimin në BE, në Departamentin e Politikës dhe Integrimit Evropian, në Kryeministri;

3. Drejtor i Drejtorisë së Miradministrimit të Pronave dhe Aseteve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Mbrojtjes;

4. Drejtor i Drejtorisë së Arsimit Cilësor dhe Gjithëpërfshirës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;

5. Drejtor i Drejtorisë së Integrimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;

6. Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Programeve të Sportit për të Gjithë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Sportit, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;

7. Drejtor i Drejtorisë së Implementimit të Operacioneve Tatimore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

8. Drejtor i Drejtorisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

9. Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore për Çështjet e Brendshme, në Ministrinë e Brendshme;

10. Kryeadministrator i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuar;

11. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

12. Drejtor i Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Lushnje;

13. Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Kujdesit Parësor dhe Shëndetit Publik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Shëndetësisë, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

14. Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

15. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

16. Drejtor i Institutit të Transportit;

17. Drejtor i Drejtorisë së Promovimit të Turizmit, në Drejtorinë e Përgjithshme për Zhvillimin e Turizmit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit;

18. Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit, Monitorimit dhe Regjistrimit të Zonave të Mbrojtura, në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;

19. Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Fondit të Trashëgimisë Kulturore, Artit, Kulturës dhe Projekteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

20. Drejtor i Drejtorisë së Transformimit Digjital, në Drejtorinë e Përgjithshme të Inovacionit dhe Teknologjisë, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

21. Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

22. Drejtor i Drejtorisë së Analizave të Strategjive Ekonomike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Informacionit dhe Analizave Ekonomike, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

23. Drejtor i Drejtorisë së Koncensioneve dhe Partneriteteve, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

II. Niveli i ulët drejtues dhe të barasvlershëm

1. Inspektor në Sektorin e Monitorimit të Procedurave të Prokurimit, në Drejtorinë Juridike dhe e Monitorimit të Procedurave, në Agjencinë e Prokurimit Publik;

2. Përgjegjës i Sektorit të Digjitalizimit të Mikrofilmit, në Drejtorinë e Evidencës, Digjitalizimit dhe Restaurimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivës;

3. Përgjegjës i Sektorit (Laboratorit) Qendror të Restaurimit, në Drejtorinë e Evidencës, Digjitalizimit dhe Restaurimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivës;

4. Përgjegjës i Sektorit të Koordinimit për Integrimin Evropian, në Departamentin e Administratës Publike;

5. Përgjegjës i Sektorit të Politikave të Rritjes Profesionale të Administratës Publike, në Departamentin e Administratës Publike;

6. Analist në Sektorin e Kërkimeve, në Drejtorinë e Programimit Strategjik, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;

7. Analist në Sektorin e Kërkimeve, në Drejtorinë e Programimit Strategjik, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;

8. Drejtor i Qendrës së Mbrojtjes Civile për Qarqet Elbasan, Berat dhe Korçë, me qendër në Korçë, në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;

9. Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit, Shkodër;

10. Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit, Korçë;

11. Përgjegjës i Sektorit të Rekrutimit dhe Promovimit, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

12. Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit në Vend, Biznes i Madh, në Drejtorinë e Kontrollit në Vend, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë;

13. Përgjegjës i Sektorit të Shkëmbimit të Informacionit, në Drejtorinë e Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

14. Përgjegjës i Sektorit të Proceseve Gjyqësore, në Drejtorinë e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Financave;

15. Përgjegjës i Sektorit të Koordinimit të Mendimeve, në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe të Përputhshmërisë, në Ministrinë e Financave;

16. Përgjegjës i Sektorit të Arkiv-Protokollit, në Drejtorinë e Shërbimeve të Përgjithshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

17. Përgjegjës i Sektorit të Financës, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

18. Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Lushnje;

19. Përgjegjës i Sektorit të Financave, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

20. Përgjegjës i Sektorit të Financës, Buxhetit, Mbledhjes së Tarifave dhe Identifikimit të Debitorëve, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit;

21. Përgjegjës i Sektorit të Ankimimeve (Apelim Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve), në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit;

22. Përgjegjës i Sektorit të Raportimit dhe Analizës, në Drejtorinë e Transformimit Digjital, në Drejtorinë e Përgjithshme të Inovacionit dhe Teknologjisë, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

23. Përgjegjës i Sektorit të Koordinimit të Projekteve, në Drejtorinë e Projekteve Inovative, në Drejtorinë e Përgjithshme të Inovacionit dhe Teknologjisë, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

24. Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit dhe Performancës, në Drejtorinë e Projekteve Inovative, në Drejtorinë e Përgjithshme të Inovacionit dhe Teknologjisë, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

25. Përgjegjës i Sektorit të Politikave të Zhvillimit, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive Inovative, në Drejtorinë e Përgjithshme të Inovacionit dhe Teknologjisë, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

26. Përgjegjës i Sektorit të Strategjisë dhe Standardizimit, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive Inovative, në Drejtorinë e Përgjithshme

të Inovacionit dhe Teknologjisë, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

27. Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit, në Drejtorinë e Koncesioneve dhe Partneriteteve, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

28. Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit dhe Zbatimit të Projekteve, në Drejtorinë e Strehimit, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

29. Përgjegjës i Sektorit të Analizës dhe të Adresimit të Problematikave të Konkurrueshmërisë, në Drejtorinë e Analizave të Strategjive Ekonomike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Informacionit dhe Analizave Ekonomike, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

30. Përgjegjës i Sektorit të Analizës, Vlerësimit dhe Adresimit të Problematikave të Zhvillimeve Sektoriale, në Drejtorinë e Analizave të Strategjive Ekonomike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Informacionit dhe Analizave Ekonomike, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

31. Përgjegjës i Sektorit të Studimit dhe Zgjerimit të Aksesit në Financë të Aktorëve të Rinj Ekonomikë, në Drejtorinë e Simulimit dhe e Observimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Informacionit dhe Analizave Ekonomike, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

32. Përgjegjës i Sektorit të Observatorit të Tregut të Punës dhe Sistemeve Inteligjente, në Drejtorinë e Simulimit dhe e Observimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Informacionit dhe Analizave Ekonomike, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

33. Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit AFP, në Drejtorinë e Politikave të Aftësimit Profesional dhe Inspektimit AFP, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Punësimit, Aftësimit Profesional dhe Sigurimeve Shoqërore, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

34. Përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Sigurisë, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

35. Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit dhe Koordinimit, në Drejtorinë e të Drejtës së Autorit, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

36. Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Programeve dhe Projekteve IPA, në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve për Çështjet e Zhvillimit Ekonomik, Kulturës dhe Inovacionit, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

37. Koordinator në Sektorin e të Drejtës Penale, në Drejtorinë e të Drejtës Penale dhe Civile, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, në Ministrinë e Drejtësisë;

38. Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Privat, në Drejtorinë e Monitorimit të Profesioneve të Lira, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë.

UDHËZIM
Nr. 8, datë 19.3.2024

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 19, DATË 22.11.2022, "PËR TARIFAT E TË ARDHURAVE DYTËSORE TË APLIKUESHME NGA INSTITUCIONET VARTËSE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar; të neneve 7, 44, 125, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të neneve 16, 18, 21, 24, 28, 33 dhe 37, të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", të ndryshuar; të nenit 14, të ligjit nr. 105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar; të neneve 14 dhe 32, të ligjit nr. 8/2019, "Për skemat e cilësisë së produkteve ushqimore dhe bujqësore"; të ligjit nr. 87, datë 14.2.2013, "Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit"; të ligjit nr. 8691, datë 16.11.2000, "Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve"; të nenit 11, të ligjit nr. 17/2020, "Për produktet plehëruese"; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; të pikës 10, të VKM-së nr. 335, datë 6.6.2018, "Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar; të pikës 9, të VKM-së nr. 223, datë 13.4.2001, "Për vlerësimin cilësor të markave të cigareve të pranishme në tregun shqiptar"; të VKM-së nr. 515, datë 19.7.2006, "Për ristrukturimin e

instituteve kërkimore shkencore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit"; dhe të VKM-së nr. 432, datë 28.6.2006, "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore", ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministri i Financave

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 19, datë 22.11.2022, "Për tarifat e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet vartëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural", bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Pika 2, ndryshon si më poshtë:

"Tarifat e përcaktuara në këtë udhëzim, nuk aplikohen për analizat e kërkuara nga:

- Institucionet e varësisë së ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

- Aplikantët e regjistruar me emërtimet EOM (Emërtim Origjine i Mbrojtur), TGJM (Tregues Gjeografik i Mbrojtur); STG (Specialitet Tradicional i Garantuar), për një periudhë 5-vjeçare, nga momenti i regjistrimit në regjistër.".

2. Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"- Tarifa e përcaktuar në këtë udhëzim për aplikimet për certifikim për produktet EOM (Emërtim Origjine i Mbrojtur), TGJM (Tregues Gjeografik i Mbrojtur); STG (Specialitet Tradicional i Garantuar), nuk aplikohet për një periudhë 5-vjeçare, nga momenti i regjistrimit në regjistër.".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

MINISTËR I FINANCAVE
Ervin Mete

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2024/04/26 13:03:25 +02'00'
375377202404261303159003 1

Çmimi 272 lekë

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)